

UNIVERSITETI PUBLIK I GJILANIT “KADRI ZEKA”
FAKULTETI I EDUKIMIT
PROGRAMI MASTER: MËSIMDHËNIE DHE KURRIKULA NË
ARSIMIN FILLOR



TEZA MASTER

Mentorja:
Prof. Asoc. Dr. Nerxhivane Krasniqi

Kandidatja:
Valentina Ahmeti

Gjilan, 2025

UNIVERSITETI PUBLIK I GJILANIT “KADRI ZEKA”
FAKULTETI I EDUKIMIT
PROGRAMI MASTER: MËSIMDHËNIE DHE KURRIKULA NË
ARSIMIN FILLOR



TEZA MASTER

Mosha optimale për regjistrim të nxënësve në klasën e parë

Mentorja:
Prof. Asoc. Dr. Nerxhivane Krasniqi

Kandidatja:
Valentina Ahmeti

Gjilan, 2025

©[2025] – [*Valentina Ahmeti*] Të gjitha të drejtat të rezervuara

FAKULTETI I EDUKIMIT

STUDIMET MASTER

PROGRAMI :MËSIMDHËNIE DHE KURRIKULA NË ARSIMIN FILLOR

TEZË MASTERI



E paraqitur nga: Valentina Ahmeti

*Në kërkim të gradës **Master***

Mentorja: Prof. Asoc. Dr. Nerxhivane Krasniqi

Tema: “Mosha optimale për regjistrim të nxënësve në klasën e parë”

Miratohet para komisionit vlerësues të përbërë nga:

1. -----
2. -----
3. -----

DEKLARATA E AUTORËSISË

Unë, Valentina Ahmeti, me numër identifikimi 23151015, shpall se kjo tezë, titulluar “ Mosha optimale për regjistrim të nxënave në klasën e parë”, është rezultat i punës time origjinale, e realizuar në kuadër të programit të studimeve master.

Puna është zhvilluar nën mbikëqyrjen e mentores Prof. Asoc. Dr. Nerxhivane Krasniqi, dhe unë konfirmoj se çdo referencë në burime të tjera është bërë në përputhje me rregullat akademike për citimin dhe referencimin.

Pjesët e paraqitura në këtë tezë nuk kanë qenë të publikuara më parë. Unë, gjithashtu konfirmoj se kam ndjekur të gjitha parimet etike gjatë realizimit të kësaj pune, duke përfshirë respektin dhe ruajtjen e konfidencialitetit kur ka qenë e nevojshme.

STATEMENT OF AUTHORSHIP

I, Valentina Ahmeti, with identification number 23151015, announce that this thesis, titled “Optimal age for enrollment of students in the first grade” is the result of my original work, carried out within the framework of the master studies program.

The work was developed under the supervision of mentor Prof. Asoc. Dr. Nerxhiavne Krasniqi, and I confirm that any reference to other sources was made in accordance with academic citation rules.

The parts presented in this thesis have not been published before.

I also confirm that I have followed all ethical principles during the course of this work, including respecting and maintaining confidentiality when necessary.

Data\Date: _____ 2025

Valentina Ahmeti
(nënshkrimi / signature)

FALËNDERIME

Dëshiroj të shpreh falendërimet e mia të sinqerta për të gjithë ata që kontribuan në arritjen e këtij punimi. Së pari, shpreh një falënderim të thellë për profesoreshën time mentore Prof. Asoc. Dr. Nerxhivane Krasniqi, e cila ka luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin tim profesional dhe akademik. Mirënjohja ime është e gjitha për përkushtimin dhe gatishmërinë me përgjigje dhe konsultime në kohë reale në lidhje me çdo paqartësi që pata gjatë realizimit të punimit.

Në anën tjetër, u jam mirënjohëse dhe shpreh falënderimin tim për të gjithë stafin profesional brenda Universitetit “Kadri Zeka”, të gjithë profesorët të cilët na e shtruan rrugën e dijes me përvojat e tyre të larmishme.

Një falënderim i veçantë shkon edhe për prindërit e mi dhe motrat të cilët gjithmonë kanë qenë mbështetje e pandërprerë dhe frymëzim për mua. Sakrificat e tyre dhe dashuria e pakushtuar më kanë ndihmuar të arrij synimet e mia.

Në hapat e përgatitjes së këtij punimi, një përkrahje dhe ndihmesë të madhe gjeta edhe nga DKA, drejtorët e shkollave, veçanërisht nga mësimdhënësit e klasës së parë dhe prindërit, të cilët janë pjesë e këtij hulumtimi, duke dhënë kontributin, dhe duke ndarë përvojat e tyre në lidhje me temën. Jam falënderuese dhe shpreh mirënjohjen më të sinqertë.

PËRMBAJTJA

ABSTRAKT	9
ABSTRACT	10
LISTA E TABELAVE	11
LISTA E FIGURAVE	12
KAPITULLI 1	13
HYRJE	13
1.1 Prezantimi i problemit.....	15
1.2 Qëllimi i hulumtimit	16
1.3 Objektivat e hulumtimit	16
1.4 Pyetjet e hulumtimit.....	16
KAPITULLI 2	17
SHQYRTIMI I LITERATURËS	17
2.1 Shkolla – themeli i Arsimit dhe Vlerave Shoqërore	18
2.2 Përkufizimi dhe rëndësia e termave “Moshë” dhe “Regjistrim” në Arsimin Fillor	20
2.3 Moshë e fillimit të shkollës në Kosovë dhe vende të tjera: një qasje krahasuese.....	22
2.4 Regjistrimi i fëmijëve (nxënësve) në klasën e parë në Kosovë	23
2.5 Moshë optimale për regjistrimin e fëmijëve në klasën e parë	25
2.6 Rëndësia e moshës kronologjike dhe zhvillimore për regjistrimin e nxënësve në klasën e parë.....	27
2.6.1 Zhvillimi fizik dhe kognitiv në fëmijërinë e mesme.....	28
2.6.2 Zhvillimi kognitiv në fëmijërinë e mesme	30
2.6.3 Zhvillimi psikosocial në fëmijërinë e mesme	31
2.7 Faktorët që ndikojnë në vendosjen e moshës optimale për regjistrimin e nxënësve në klasën e parë.....	33
2.7.1 Faktorët biologjikë dhe psikologjikë	34
2.7.2 Faktorët familjarë dhe socialë	35
2.7.3 Faktorët arsimorë dhe politikë	38
2.8 Çka përfshin Gatishmëria për shkollë ?	38
2.8.1 Gatishmëria shkollore në diskutimin edukativo-psikologjik	41
2.8.2 Gatishmëria për shkollë sipas pikëpamjes së psikologëve dhe pedagogëve.....	42

2.9 Përgatitja e fëmijëve për klasën e parë	43
2.9.1 Komponentët kryesorë të përgatitjes për shkollë.....	43
2.9.2 Veçoritë e arsimit fillor (klasat I-V)	47
KAPITULLI 3	48
METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	48
3.1 Lloji dhe qasja e hulumtimit	48
3.2 Pyetjet e hulumtimit.....	48
3.3 Hipotezat e hulumtimit	49
3.4 Popullata dhe mostra e hulumtimit	49
3.5 Instrumenti i mbledhjes së të dhënave	50
3.6 Procedura e analizës së të dhënave	50
3.7 Etika e hulumtimit.....	50
INTERPRETIMI I REZULTATEVE	51
3.8 Rezultatet e të dhënave në formën tabelare dhe të figurave nga pyetësi i realizuar me mësimdhënësit.....	51
Rezultatet e të dhënave në formën tabelare dhe të figurave nga pyetësi i realizuar me prindër	64
PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME.....	77
3.9 REKOMANDIMET NGA MËSIMDHËNËSIT	79
3.10 REKOMANDIMET NGA PRINDËRIT	80
Bibliografia	83
SHTOJCAT	86
Shtojca A: PYETËSOR PËR MËSIMDHËNËS	86
Shtojca B: PYETËSOR PËR PRINDËR	90

ABSTRAKT

Mosha optimale e regjistrimit të nxënësve në klasën e parë është një çështje me rëndësi të veçantë për zhvillimin e tyre akademik dhe psiko-social. Ky hulumtim ka për qëllim të analizojë ndikimin e moshës së regjistrimit në procesin e të nxënësve dhe përshtatjen e fëmijëve në klasën e parë, duke u bazuar në perceptimet e prindërve dhe mësuesve.

Hulumtimi është realizuar në pesë shkolla të qytetit të Gjilanit. Shkollat e përfshira në hulumtim janë: SHFMU “Selami Hallaçi”, SHFMU “Musa Zajmi”, SHFMU “Sadulla Brestovci”, SHFMU “Thimi Mitko” dhe SHFMU “Rexhep Elmazi”.

Pjesëmarrës në hulumtim kanë qenë mësuesit e klasës së parë dhe prindërit e nxënësve të klasës së parë, me qëllim që të mblidhen perspektiva të ndryshme mbi efektet e moshës së regjistrimit.

Për mbledhjen e të dhënave është përdorur një pyetësor i strukturuar me pyetje të mbyllura, i ndarë në dy versione – një për prindërit dhe një për mësuesit. Analiza statistikore ka mundësuar krahasimin e qëndrimeve dhe vlerësimeve të dy grupeve pjesëmarrëse.

Rezultatet tregojnë se prindërit dhe mësuesit shpesh kanë pikëpamje të ndryshme; një pjesë e prindërve mbështesin regjistrimin në moshën 6-vjeçare, duke e konsideruar atë të favorshme për zhvillimin akademik, ndërsa të tjerë preferojnë moshën 7-vjeçare, duke argumentuar për pjekurinë psikologjike, emocionale dhe sociale të fëmijës. Nga ana tjetër, mësuesit bazojnë qëndrimet e tyre në përvojën pedagogjike, duke theksuar ndikimin e moshës në procesin e të nxënësve.

Gjetjet e këtij studimi ofrojnë një bazë krahasuese për hulumtimet e ardhshme mbi këtë temë, duke ndihmuar në zhvillimin e politikave arsimore më të përshtatshme.

Studiuesit e ardhshëm mund t’i përdorin këto të dhëna për të analizuar ndryshimet në perceptime dhe kontekste të tjera, duke e përfshirë origjinalitetin e burimit nga ku janë marrë.

Fjalët kyçe: *zhvillimi kognitiv dhe socio-emocional, regjistrimi në klasën e parë, mosha, ndikimi i faktorëve përcaktues, gatishmëria për shkollë.*

ABSTRACT

The optimal age of enrollment of students in the first grade is a matter of special importance for their academic and psycho-social development. This research aims to analyze the impact of enrollment age on the learning process and adaption of children in the first grade, based on the perceptions of parents and teachers.

The research was carried out in five schools of the city of Gjilan. The schools involved in the research are: SHFMU “Selami Hallaçi”, SHFMU “Musa Zajmi”, SHFMU “Sadulla Brestovci”, SHFMU “Thimi Mitko”, and SHFMU “Rexhep Elmazi”.

Participants in the research were first-grade teachers and parents of first-grade students, with the aim of gathering different perspective on the effects of enrollment age.

For data collection, structured questionnaire with closed-ended questions was used, divided into two versions – one for parents and one for teachers. Statistical analysis enabled the comparison of attitudes and evaluations of the two participating groups.

The result show that parents and teachers often have different views: some of them support registration at the age of 6, considering it favorable for academic development, while others prefer the age of 7, arguing for the child’s readiness. On the other hand, teachers base their attitudes in the pedagogical experience, emphasizing the influence of age in the learning process. The findings of this study provide a comparative basis for future research on this topic, helping to develop more appropriate educational policies.

Future researches can use this data to analyze changes in percentages and other contexts, including source authenticity.

Key words: *cognitive and socio-emotional development, enrollment in first grade, age, influence of determining factors, readiness for school.*

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Numri i mësimdhënësve pjesëmarrës në hulumtim për shkolla.	51
Tabela 2. Rezultatet e analizës së të dhënave të mbledhura për moshën mesatare të nxënësve që regjistrohen në klasën e parë.	54
Tabela 3. Rezultatet e analizës së të dhënave për faktorët më të rëndësishëm në përcaktimin e moshës së regjistrimit në klasën e parë.	58
Tabela 4. Rezultatet e analizës së të dhënave për sfidat me nxënësit e rinj në klasën e parë.	59
Tabela 5. Rezultatet e analizës së të dhënave për mënyrën më të mirë për të informuar prindërit mbi gatishmërinë e fëmijëve të tyre për regjistrimin në klasën e parë.	63
Tabela 6. Rezultatet e analizës së të dhënave të mbledhura për ndjekjen e çerdhes ose kopshtit nga fëmija para regjistrimit në klasën e parë.	65
Tabela 7. Rezultatet e analizës së të dhënave të mbledhura për diskutimin e prindërve me psikologun e shkollës, mësuesit apo edhe prindërit e tjerë.	68
Tabela 8. Rezultatet e analizës së të dhënave të mbledhura për emocionet e fëmijëve në ditët e para të shkollës.	69
Tabela 9. Rezultatet e analizës së të dhënave të mbledhura për ndikimin e moshës së regjistrimit në suksesin e fëmijës.	73
Tabela 10. Rezultatet e analizës së të dhënave të mbledhura për përshtatshmërinë e programit mësimor në klasën e parë.	75

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Analizimi i të dhënave të mbledhura për përvojën e mësimdhënësve të klasës së parë.	52
Figura 2. Analizimi i të dhënave të mbledhura për numrin mesatar të nxënësve në klasën e parë.....	53
Figura 3. Analizimi i të dhënave të mbledhura për kriterin e pranimit të nxënësve në klasën e parë.....	55
Figura 4. Analizimi i të dhënave të mbledhura për përgatitjen e fëmijëve në përshtatjen e rregullave dhe rutinës shkollore.....	56
Figura 5. Analizimi i të dhënave të mbledhura për aftësitë e gatishmërisë së fëmijëve.....	57
Figura 6. Analizimi i të dhënave të mbledhura për dallimin e performancës së nxënësve në varësi të moshës së regjistrimit.	60
Figura 7. Analizimi i të dhënave të mbledhura për vështirësinë e nxënësve në fusha të caktuara.	61
Figura 8. Analizimi i të dhënave të mbledhura për moshën e përshtatshme për regjistrimin e nxënësve në klasën e parë.	62
Figura 9. Analizimi i të dhënave të mbledhura për gjininë e fëmijës.....	64
Figura 10. Analizimi i të dhënave të mbledhura për moshën e regjistrimit.....	66
Figura 11. Analizimi i të dhënave të mbledhura për arsyet e përzgjedhjes së moshës së regjistrimit.....	67
Figura 12. Analizimi i të dhënave të mbledhura për mbështetjen e mësuesve në ndihmën për t'u përshtatur fëmijët emocionalisht në klasën e parë.	70
Figura 13. Analizimi i të dhënave për sfidat e përjetura nga fëmijët në fillimin e klasës së parë.	71
Figura 14. Analizimi i të dhënave të mbledhura për përgatitjen e fëmijëve për klasën e parë dhe aktivitetet e përdorura nga ana e prindërve.	74
Figura 15. Analizimi i të dhënave të mbledhura mbi opinionin e prindërve për moshën e përshtatshme të regjistrimit të fëmijëve në klasën e parë.	76

KAPITULLI 1

HYRJE

Ky punim lindi nga interesi im personal dhe profesional për të kuptuar rëndësinë e moshës së regjistrimit të fëmijëve në klasën e parë. Kjo temë merr ngjyrim emocional, në veçanti kur flasim për fëmijët që shënon fillimin e karrierës shkollore.

Mosha e fillimit të klasës së parë i referohet një periudhe kritike në të cilën fëmijët hyjnë në jetën arsimore. Kjo grupmoshë kërkon një ekuilibër midis nevojave zhvillimore të fëmijëve dhe kërkesave të sistemit arsimor. Sidomos duke marrë parasysh zhvillimin njohës, social dhe emocional të fëmijëve, mosha e fillimit të klasës së parë ka një rëndësi të caktuar.

Kjo temë ka tërhequr vëmendjen e studiuesve, politikëbërësve dhe prindërve, pasi koha e fillimit të arsimit formal mund të ndikojë në performancën akademike, aftësitë sociale dhe mirëqenien emocionale të fëmijëve. (Datar, 2006).

Sipas ligjit, fëmijëve u kërkohet të ndjekin shkollën që nga një moshë e caktuar. Në shumë vende, mosha e regjistrimit në klasën e parë përcaktohet nga rregulloret e Ministrisë të Arsimit, zakonisht rreth moshës gjashtëvjeçare. Megjithatë, kjo qasje uniforme shpesh nuk merr parasysh dallimet individuale të fëmijëve në aspektin e gatishmërisë për shkollë. Ndërsa disa fëmijë janë të përgatitur për të përballuar kërkesat e mësimin në atë moshë, të tjerë mund të përballen me vështirësi që ndikojnë negativisht në përvojën e tyre të parë shkollore.

Në procesin e zhvillimit psiko-fizik të fëmijës, hulumtimet që janë bërë, përkitazi me përgatitjen a pjekurinë e tyre për mësim e shkollë, kanë konstatuar se ekziston një kohë a moshë optimale, kur fëmija, përkatësisht nxënësi, mund të arrijë më shumë sukses në përvetësimin e diturive, shkathtësive dhe shprehive. (Dërvodeli, 2010).

Si studente e angazhuar në fushën e arsimit, gjatë studimeve dhe nga vëzhgimet gjatë praktikës sime profesionale kam hasur në sfida të ndryshme që përjetojnë nxënësit në klasën e parë – disa për shkak të moshës së hershme, e të tjerë për shkak të mosgatishmërisë së përgjithshme. Kjo më nxiti të hulumtoj më thellë mbi pyetjen:

Cila është moshë më e përshtatshme për të filluar shkollën (klasën e parë)?

Me qëllim të gjithëpërfshirjes së fëmijëve në sistemin arsimor që në fillim të shkollimit, është e rëndësishme të analizojmë në mënyrë të kujdesshme moshën më të përshtatshme për regjistrimin në klasën e parë. Përcaktimi i një moshe optimale për të gjithë fëmijët mund të mos i përgjigjet nevojave individuale të zhvillimit kognitiv, emocional dhe social të tyre. Prandaj, ne, si mësimdhënës, kemi për detyrë të vlerësojmë gatishmërinë për shkollë përmes metodave të përshtatshme dhe me qasje të ndjeshme, duke siguruar që fëmijët të mos dihen të papërgatitur ose të përjashtuar.

Marrë parasysh rëndësinë e informimit, këtë tematikë e kam trajtuar në kapitull të veçantë, ku kam trajtuar aspekte zhvillimore të fëmijëve, faktorët që ndikojnë në përcaktimin e moshës për hyrjen në shkollë, përgatitjen dhe gatishmërinë e fëmijëve për shkollë.

Zhgedhja e moshës jo të përshtatshme, ndikon në rezultate jo të mira të të nxënësve, e këto rezultate më pas në demotivimin e nxënësve, ndjenjat e të qenurit i paaftë për të arritur diçka,

Përmes shqyrtimit të literaturës shkencore, rekomandimeve nga ana e prindërve dhe mësimdhënësve që janë partnerë në fushën e arsimit, synohet të ofrohet një pasqyrë e qartë në mënyrë që informatat për regjistrim të jenë sa më të përshtatura me nevojat individuale të fëmijës.

Punimi përfshin të dhëna empirike lidhur me tematikën e dhënë, duke e ndarë në kapituj dhe duke e paraqitur me statistika të cilat janë të detajura për secilën pikë.

1.1 Prezantimi i problemit

Marrja e vendimit në lidhje me momentin/kohën e duhur për ta dërguar fëmijën në shkollë shpesh është subjektiv dhe ndikohet nga faktorë të ndryshëm, nga pritjet e prindërve dhe rekomandimet e profesionistëve. Në realitet, shkollat i grupojnë nxënësit thjesht sipas moshës, por dihet se niveli i zhvillimit intelektual i fëmijës nuk varet ekskluzivisht nga mosha, por edhe nga faktorë të tjerë. Kështu, për shembull, një fëmijë 6 vjeç i rritur në një mjedis nxitës për të mësuar ka shumë më tepër gjasa të jetë më i përgatitur për shkollë sesa një 7-vjeçar që është rritur në një mjedis dekurajues, ndoshta pa mbështetjen e duhur për ndjekjen e shkollës.

Fëmijët zhvillohen ndryshe, investohet ndryshe në ta dhe arrijnë nivele të ndryshme në kohë të ndryshme. Në Kosovë, legjislacioni arsimor lejon regjistrimin në klasën e parë në moshën gjashtëvjeçare. Megjithatë, në praktikë, ky vendim shpesh ndikohet nga qëndrimet e prindërve dhe rekomandimet e mësimdhënësve. Prindërit përballen me dilema të shumta: a është fëmija im i mjaftueshëm i pjekur për të filluar shkollën? A do të përshtatet emocionalisht dhe socialisht me strukturën shkollore?

Ndonjëherë një fëmijë është mjaft i gatshëm për shkollë për sa i përket aftësive njohëse dhe zhvillimit fizik (“njohës” këtu i referohemi gjithçka që ka të bëjë me të menduarit dhe të mësuarit, por ndihet i/e pasigurt ndaj të tjerëve, ende i mungon pjekuria sociale dhe emocionale. Prandaj një nga elementet më të rëndësishëm për t’u marrë parasysh është pjekuria sociale dhe emocionale e fëmijës. Për shkak të dallimeve zhvillimore midis fëmijëve, është e rëndësishme që prindërit të vlerësojnë plotësisht gatishmërinë e fëmijës së tyre.

Në këtë kontekst, hulumtimi do të fokusohet në identifikimin e faktorit determinant për moshën optimale të regjistrimit dhe në vlerësimin e ndikimit të kësaj moshe mbi zhvillimin e fëmijëve dhe procesin mësimor.

1.2 Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi i këtij hulumtimi është të analizojmë dhe identifikojmë faktorët siç janë zhvillimi kognitiv, emocional dhe social në moshën më të përshtatshme, si dhe perceptimet e prindërve dhe mësuesve për regjistrimin e fëmijëve në sistemin arsimor, me qëllim që të sigurojmë një fillim të suksesshëm të tyre në arsim. Hulumtimi ka për qëllim të kontribuojë në krijimin e një baze të dhënash, që do të mundësojë prindërit të marrin vendime të mirëinformuara mbi çështjet e regjistrimit të nxënësve në klasën e parë.

1.3 Objektivat e hulumtimit

1. Të përcaktojmë moshën optimale të regjistrimit të nxënësve në klasën e parë.
2. Të vlerësojmë gatishmërinë kognitive, sociale dhe emocionale të nxënësve bazuar në moshën e regjistrimit.
3. Të analizojmë perceptimet dhe opinionet e prindërve dhe mësuesve lidhur me moshën optimale të regjistrimit.
4. Të identifikojmë faktorët që ndikojnë në vendimin për regjistrim të nxënësve në klasën e parë,

1.4 Pyetjet e hulumtimit

Duke u bazuar në shqyrtimin e studimeve (literaturës) janë ngritur në vijim pyetjet kërkimore:

1. A ka dallime në perceptimet e prindërve dhe mësuesve mbi ndikimin e moshës së regjistrimit në përgatitjen e fëmijës për shkollë?
2. Cilët janë faktorët përcaktues që ndikojnë në vendimin për regjistrim të nxënësve në klasën të parë?
3. Cilat janë sfidat më të zakonshme me të cilat përballen nxënësit që regjistrohen në moshë më të hershme apo më të vonshme në klasën e parë?

KAPITULLI 2

SHQYRTIMI I LITERATURËS

Përfshirja e fëmijëve në sistemin arsimor është një çështje, e cila është trajtuar nga autorë vendas dhe autorë, psikologë e pedagogë të huaj, të cilët kanë analizuar aspekte zhvillimore, psikologjike dhe sociale të këtij procesi.

Një pjesë e konsiderueshme e literaturës në këtë temë fokusohet në aspektin psikologjik, konkretisht nga studimet e Jean Piaget dhe Lev Vygotsky, të cilët ofrojnë baza të rëndësishme teorike mbi zhvillimin njohës dhe social.

Piaget thekson se fëmijët kalojnë nëpër faza të ndryshme të zhvillimit kognitiv, të cilat mund të ndikojnë në gatishmërinë e tyre për të filluar shkollën.

Në anën tjetër, Vygotsky vë theksin tek roli i ndërveprimit social dhe mjedisit në zhvillimin e fëmijëve, duke sugjeruar se mbështetja nga prindërit, mësuesit dhe bashkëmoshatarët luajnë një rol kyç në tranzicionin e suksesshëm nga edukimi parashkollor në atë fillor.

Një rëndësi e veçantë ka edhe cilësia e arsimit parashkollor, pasi jo vetëm mosha por edhe përvoja që fëmijët marrin në këto institucione ndikon shumë në përgatitjen e tyre në shkollë.

Studimet krahasuese mbi sistemet arsimore në vende të ndryshme kanë treguar se mosha e regjistrimit dhe kriteret për hyrjen në shkollë mund të ndryshojnë në varësi të politikave arsimore dhe kontekstit social-ekonomik të secilit vend. (OECD, 2017). Në këtë drejtim, është me rëndësi të bëhet një krahasim mes vendeve të ndryshme dhe Kosovës për të parë kriteret dhe faktorët të cilët merren për bazë në kohën kur fëmijët hyjnë në sistemin arsimor për të kuptuar ndikimet e tyre në zhvillimin dhe performancën akademike të fëmijëve.

Në kapitullin në vijim janë trajtuar më gjerësisht këto pika, duke u ndalur në mënyrë të veçantë te zhvillimi i fëmijëve dhe përgatitja e tyre për fillimin e klasës së parë.

2.1 Shkolla – themeli i Arsimit dhe Vlerave Shoqërore

Shkolla është një institucion shoqëror, një formë komuniteti në të cilën të gjitha degët e saj të mësimdhënies janë të përqendruara të jenë sa më efektive në nxitjen e fëmijës. Shkolla duhet të përfaqësojë tek fëmija jetën aktuale, jetën e gjallë dhe reale që ai bën në shtëpi, në lagje apo në sheshin e lojërave. Shkolla duhet të paraqesë aktivitetet në mënyrë që fëmija të mësojë gradualisht kuptimin e tyre dhe t'i ndërlidhë ato. (Zabeli, 2023).

Shkolla, sipas Prof. Dr. Hajrullah Koliqit, “është institucion më qytetërues, më i organizuar dhe më profesional i arsimit dhe i sistemit arsimor, ku realizohet mësimi”.

Koha që shumë djem dhe vajza largohen nga kopshti i fëmijëve dhe më në fund hyjnë në një jetë si nxënës shkolle, është një kohë emocionuese për nxënësit e klasës së parë dhe prindërit e tyre, sepse shumë gjëra do të ndryshojnë. Dhe shumë prindër sigurisht që janë të shqetësuar nëse fëmija i tyre do të plotësojë kërkesat e klasës së parë, nëse ka fituar aftësinë e nevojshme shkollore. Konsultimi me pediatrën apo mësuesit e kopshteve nuk është gjithmonë i mundur dhe vetëm data e lindjes nuk është gjithmonë një garanci se do të funksionojnë në shkollë. Shumë prindër nuk i dinë kriteret që aplikohen për gatishmërinë në shkollë. Por frika, pasiguria dhe dyshimi nuk janë ndjenja të mira me të cilat prindërit duhet ta dërgojnë fëmijën e tyre në shkollë.

Shumica e fëmijëve mezi presin që më në fund të fillojnë shkollën. Megjithatë, shkolla është diçka krejt ndryshe. Këtu, fokusi nuk është më te loja, por te të mësuarit.

Kur fëmijët vijnë në shkollë, mësuesit presin që ata të ndjekin udhëzime dhe kërkesa të thjeshta, të ulen të qetë në karrige për një periudhë të caktuar kohe, me të tjerët, dhe të punojnë së bashku. (Stamm, n.d). Periudha e shkollës fillore zë një vend shumë të rëndësishëm në jetën akademike të nxënësve. Nxënësit, të cilët fillojnë të njohin mjedisin e tyre duke vënë këmbën në një mjedis të ndryshëm nga shtëpia e tyre për herë të parë gjatë arsimit parashkollor, fillojnë të krijojnë marrëdhënie me mjedisin e tyre dhe të shoqërohen në periudhën e shkollës fillore.

Ky proces shihet si fillimi i një procesi shumë të rëndësishëm për nxënësit, pasi nxënësit që fillojnë të fitojnë njohuri dhe aftësi bazë në të ardhmen fillojnë të mësojnë të lexuarit dhe të shkruarit duke fituar përvoja të ndryshme. (Erkan & Topcu Bilir, 2015). Përshtaten me mjedisin e tyre dhe vazhdojnë edukimin e tyre akademik, social dhe kulturor.

Në edukimin e fëmijëve gjashtë vjeçar një vend të rëndësishëm duhet të zërë realizimi i edukimit të ndjesës pozitive për shkollën. Këtu duhet të merren parasysh veçoritë individuale të fëmijëve, sidomos cilësitë e temperamentit. Veçanërisht e vështirë është përshtatja me mjedisin shkollor, ku kërkohet punë serioze, kjo shkakton ndjenja të forta frike, mosbesimi në forcat e tyre dhe si rrjedhim emocione negative ndaj jetës së shkollës. (Vadahi, 2002).

Shkollat duhet të krijojnë mjedise mësimore të efektshme. Është detyrë e shkollës të krijojë mjedise në të cilat nxënësit të jenë aktivë në ndërtimin e një kuptimi të thellë vetjak, në mënyrë që të mund të arsyetojmë rreth problemeve të botës reale dhe ta transferojnë të nxënit e tyre nga shkolla në jetën e përditshme, përtej mureve të shkollës. (Woolfolk, 2011).

Fëmijët kanë nevojë për mjedise të qëndrueshme, të dashura dhe stimuluese që u japin atyre vëmendje dhe kujdes. Kjo është mënyra e vetme që ata mund të eksplorojnë botën në mënyrë të sigurtë, udhëzimi, inkurajimi dhe stimulimi janë tre elemente bazë për këtë. (Stamm, n.d).

Nxënësit e ciklit të ulët të shkollës fillore qëndrojnë në shkollë një kohë relativisht të gjatë dhe këtë kryesisht në klasë. Shkolla fillore si institucion unik arsimor-edukativ e interes të posaçëm shoqëror duhet të sigurojë kushte optimale për zhvillimin e gjithmbarshëm të personalitetit të nxënësve dhe të ngritjes së nivelit arsimor e kulturor të popullatës përreth. (Brada, 1984).

Shkolla fillore është shkollë e detyrueshme për të gjitha gjeneratat e reja, të moshës 7-15 vj. (tani prej 6-14 vj.), prej së cilës shoqëria pret që, këtë shkallë të shkollimit, ta kryej përqindja më e madhe e të rinjve. Kjo do të thotë se, pavarësisht nga dallimet, që ekzistojnë ndërmjet nxënësve, duke i marrë për bazë aftësitë, inteligjencën, motivimin, kushtet familjare dhe të tjera, shkollën fillore ta kryejnë sa më shumë të rinj, që është një parakusht i arsimimit të tyre të mëtejshëm. (Dërvodeli, Januz, 2010).

Është vështirë për fëmijët dhe prindërit e tyre kalimi nga kopshti në shkollën fillore. Planifikimi dhe përgatitja e kujdesshme në kopsht duhet të ndihmojë në lehtësimin dhe zbutjen e kalimit nga edukimi parashkollor në atë shkollor. Element kryesor i planifikimit për zbutjen e kalimit nga kopshti në shkollën fillore duhet të jetë sigurimi se stafi pedagogjik i kopshtit dhe ai i shkollës fillore njohin filozofinë, programin dhe pikësynimet për fëmijët.

Mbi këto njohuri duhet të hartohen programet e kalimit nga kopshti në shkollën fillore për ta bërë më të lehtë përshtatjen e fëmijëve me punën e përditshme në shkollë dhe për të lehtësuar edhe prindërit nga stresi i këtij kalimi. Planifikimi dhe aktiviteti i kalimit nga kopshti në shkollën fillore duhet të përfshijë njohjen e mësueses së klasës së parë me përparësitë dhe nevojat e çdo fëmije, inkurajimin e përfshirjes së prindërve dhe pajisjen e mësuesve të ciklit fillor me informacionin e nevojshëm rreth praktikave të edukimit që përdoren në kopsht. (Vadahi, 2002).

2.2 Përkufizimi dhe rëndësia e termave “Moshë” dhe “Regjistrim” në Arsimin Fillor

Regjistrimi në klasën e parë përbën një nga hapat më të rëndësishëm në sistemin arsimor të çdo fëmije. Një aspekt kyç i këtij procesi është mosha e fëmijëve që çdo vit paraqiten për t’u regjistruar. Mosha është një koncept i përhershëm që mund të kuptohet në disa mënyra:

Termi *moshë* nënkupton kohën, që nga lindja e një njeriu a një qenieje tjetër të gjallë, e deri në një çast të caktuar të jetës së tyre; vitet e jetës që ka mbushur një njeri, ...që nga çasti kur ka lindur, periudhë ose etapë në jetën e një qenieje të gjallë me karakteristikat të caktuara, me tipare dalluese etj.

Mosha, mund të nënkuptohet si fazë a periudhë në zhvillimin e njeriut, si, p.sh: *mosha fëmijërore*, *mosha rinore*, *mosha e pjekurisë*, *mosha e pleqërisë*, *mosha pas-profesionale*. Termi *moshë* ka shumë kuptime, prandaj duhet ta përdorim me shumë kujdes, si dhe në përputhje me kontekstin e përdorimit të tij, sepse mund të flitet edhe për *moshë shkollërore*, pastaj për *moshën e shkollës fillore*, *moshën e shkollës së mesme* etj. (Dërvodeli, Januz, 2010).

(Dërvodeli, Januz, 2010), po ashtu, thekson se, termi ***moshë kalendarike ose moshë kronologjike***, “nënkupton kohën prej lindjes (duke e nënkuptuar datëlindjen, muajin, dhe vitin e lindjes, jo sipas deklarimeve, dëshmive gojore, siç ishte bërë zakon të shumtën, në të kaluarën), e deri në çastin kur llogaritet të ketë përfunduar pleqëria”.

Mosha zhvillimore – ky term i referohet zhvillimit psikologjik, emocional, dhe fizik të individit në lidhje me moshën kronologjike. Ndryshe nga mosha kronologjike, mosha zhvillimore merr parasysh aspektet e zhvillimit dhe është më shumë e fokusuar në arritjet dhe aftësitë që individi ka fituar në një periudhë të caktuar, p.sh., zhvillimi kognitiv, motorik, dhe social.

Mosha fëmijërore (7-8) – Kjo periudhë nënkupton kohën e vijimit të filloristëve në shkollë, që nga ditët e para. Në këtë periudhë, më shumë se kurrë më parë, duhet ofruar ndihmë sistematike, duke i motivuar ata për punë, duke marrë për bazë moshën psiko-fizike të tyre, duhet ndihmuar për një përshtatje sa më të mirë në një mjedis të ri shkollor dhe për një sjellje në përgjithësi, sepse me ardhjen në shkollë, fëmija e ndryshon mënyrën e jetës së tij. (Dërvodeli, "Zhvillimi historik i institucioneve parashkollore", n.d).

Termi regjistrim (regjistroj), shikuar nga këndvështrimi i qasjes së problemit të hulumtimit tonë, nënkupton shënimin e emrit dhe të mbiemrit në një listë, që shërben si dokument, për të treguar pranimin në një shkollë të individit (në këtë rast pranimin e fëmijës në shkollën fillore) ose që të marrë pjesë në një punë a veprimtari tjetër.

2.3 Mosha e fillimit të shkollës në Kosovë dhe vende të tjera: një qasje krahasuese

Arsimi fillor është një nga fazat më të rëndësishme në zhvillimin akademik të fëmijëve, dhe mosha në të cilën ata fillojnë shkollën ndryshon në varësi të politikave arsimore të vendeve të ndryshme. Sipas (Vosnidau, 2001), mosha e regjistrimit të fëmijëve në klasën e parë nuk është e njëjtë në të gjitha vendet dhe varet nga faktorë si politikat shtetërore, zhvillimi kognitiv i fëmijëve dhe qasja ndaj edukimit. Sipas (Dërvodeli, 2010), në shtetet e ndryshme të Evropës dhe të botës, mosha kronologjike nuk përcaktohet me dispozita ligjore, si moshë e njëjtë e të gjithë fëmijëve, për nisje në shkollë; kriteri i moshës është relative, varësisht nga shtetet e ndryshme, sepse diku fëmijët janë të detyruar, me ligj, ta vijojnë shkollën, në moshën 5 vjeç, diku në moshën 6 vjeç, ndërsa diku tjetër në moshën 7 a 8 vjeç.

Pikërisht kur fëmijët regjistrohen në shkollë ndryshon nëpër botë. Në shumicën e vendeve evropiane, mosha e zakonshme për të filluar shkollën fillore është midis 5 dhe 7 vjeç. Për shembull, në Britaninë e Madhe dhe Holandë, fëmijët fillojnë shkollën në moshën 5 vjeç, ndërsa në Gjermani dhe Francë, ata regjistrohen në moshën 6 vjeç. (Meisels, 1992).

Hyrja në shkollë është vendosur në 6 në Rusi, Australi, Japoni . Në Suedi, fëmijët hyjnë në shkollë në moshën 7 vjeç. Megjithëse hyrja në shkollë ndryshon gjithashtu në të gjithë Shtetet e Bashkuara, me datat e fundit të lindjes për regjistrimin e vendosur zakonisht nga shteti, fëmijët në shkollat tradicionale amerikane fillojnë shkollën rreth moshës 5 vjeç, duke i vendosur Shtetet e Bashkuara në pjesën më të hershme të moshave të hyrjes në shkollë kur krahasohen me vende të tjera, siç theksohet nga (Stipek, 2002).

Në Zvicër, fëmijët fillojnë shkollën në moshën mesatare shtatëvjeçare. Nga hulumtimet e kryera në Zvicër, siç ceket në artikullin shkencor Der Schuleintritt (Hyrja në shkollë) nga Prof. Dr. Margrit Stamm ende nuk ka arritur qëllimi që të gjithë fëmijët të kenë përafërsisht të njëjtat mundësi fillimi kur të fillojnë shkollën dhe të jenë gati për të mësuar në shkollë. Megjithatë hulumtimi ka fituar shumë njohuri se pse qëllime të tilla janë kaq të rëndësishme dhe si mund të arrihen ato. Në Zvicër, fëmijët fillojnë shkollën në moshën mesatare shtatëvjeçare.

Një rishikim i madh i kohëve të fundit i literaturës mbi moshën në hyrje në shkollë arrin në përfundimin se çdo avantazh akademik për nxënësit më të rritur zhduket nga klasa e tretë. Teoritë e zhvillimit të fëmijëve argumentojnë se mosha në hyrjen në shkollë lidhet gjithashtu me mirëqenien emocionale dhe sjelljen e nxënësve. Provat empirike nuk japin konkluzione të qarta nëse nxënësit më të vjetër apo më të rinj janë ata që vuajnë emocionalisht. Disa kërkime dokumentojnë probleme emocionale për nxënësit më të rinj që rezultojnë nga vetëvlerësimi i ulët, stresi dhe qëndrimet negative ndaj shkollës sipas (Lincove & Painter, 2006).

Një studim i (OECD, 2017), thekson se vendet me një moshë më të lartë të hyrjes në shkollë shpesh kanë rezultate më të mira në teste ndërkombëtare si PISA.

2.4 Regjistrimi i fëmijëve (nxënësve) në klasën e parë në Kosovë

Kosova ka ndjekur një sistem të ngjashëm me atë të vendeve të tjera evropiane. Deri në vitin 2010, fëmijët në Kosovë fillonin shkollën në moshën 7 vjeç, por me reformat e fundit arsimore, mosha e regjistrimit u ndyshua në 6 vjeç, duke u përshtatur me trendet ndërkombëtare. Qëllimi i këtij ndryshimi ishte që fëmijët të kishin më shumë vite shkollimi të detyrueshëm dhe të përgatiteshin më herët për tregun e punës dhe arsimin e lartë.

Për regjistrimin e fëmijëve në klasën e parë, **Udhëzimi Administrativ** në Kosovë **MASHT nr.34/2014** përcakton rregullat mbi moshën, dokumentet e nevojshme, afatet dhe mënyrat e regjistrimit.

Sipas **Nenit 2**, të këtij Udhëzimi fëmija mund të regjistrohet në klasën e parë pasi t'i ketë mbushur moshën minimale (gjashtë vjet), por mund të regjistrohet edhe nën moshën minimale të arimit të detyruar, në fillim të vitit shkollor.

Neni 3 – (3.1) Dokumentacioni Për regjistrim në klasë të parë, fëmiju duhet të ketë certifikatën e lindjes.

Neni 4 - (4.1.) Në Kosovë, regjistrimi i fëmijëve në klasë të parë, fillon më 17 maj dhe zgjat deri më 7 qershor.

Neni 5 - (5.1.) Fëmijët i nënshtrohen një vlerësimi profesional, lidhur me përcaktimin e shkallës së aftësive të tij dhe kategorizimi.

5.2. Vlerësimi bëhet nga organi profesional i shkollës:

- a) Mësuesi/ja
- b) Pedagogu,
- c) Psikologu.

5.3. Vlerësimi dhe regjistrimi i nxënësve bëhet në prani të (së paku) njërit nga prindërit (kujdestarit).

Në ***Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës*** theksohet se, shkollimi i detyruar fillon në fillim të vitit shkollor pas datës kur fëmija arrin moshën gjashtë (6) vjeçare që është mosha minimale për shkollimin e detyruar dhe përfundon në fund të nivelit 2 të ISCED- it.

Fëmija, i cili në kohën e fillimit të vitit shkollor është nën minimumin e moshës së duhur për shkollimin e detyruar mund të regjistrohet në këtë shkollim në bazë të rekomandimit të shërbimit profesional pedagogjiko-psikologjik në shkollë. Vendimi për regjistrim merret nga drejtori i shkollës. Në përgjithësi, shkalla e përfshirjes bruto të fëmijëve/nxënësve, në krahasim me vitet paraprake ka shënuar rënie në gati të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar. Sipas Raportit statistikor 2020/21, në krahasim me vitin paraprak, shkalla e përfshirjes së fëmijëve në arsimin parafillor është 88.1% me një rënie prej 0.1% dhe në arsimin e mesëm të lartë është 81.1% me një rënie prej 4.3%.

Vetëm në arsimin fillor, shkalla e përfshirjes është 101.2% me një rritje prej 0.6%. Falë qendrave mësimore, shkalla e regjistrimit në arsimin e detyrueshëm u rrit, ndërsa braktisja u zvogëlua në masë të madhe, edhe pse financimi i tyre nuk është i qëndrueshëm. (Ministria e Arsimit, Strategjia e Arsimit Parauniversitar në Republikën e Kosovës 2022-2026, 2022).

2.5 Mosha optimale për regjistrimin e fëmijëve në klasën e parë

Mosha e fillimit të shkollës është një faktor kyç që ndikon në zhvillimin akademik dhe social të fëmijëve. Sipas hulumtimeve në fushën e edukimit dhe psikologjisë zhvillimore, mosha optimale për regjistrimin e fëmijëve në klasën e parë varion midis 6 dhe 7 vjeç. Në varësi të zhvillimit kognitiv, emocional dhe social të tyre. (Bertram & Pascal, 2016).

Mosha optimale për regjistrimin e nxënësve në klasën e parë është një çështje e rëndësishme që ndikon në zhvillimin akademik dhe social të fëmijëve. Literatura shkencore sugjeron se një moshë optimale për fillimin e shkollës është midis 6 dhe 7 vjeç, duke marrë parasysh zhvillimin kognitiv, emocional dhe social të fëmijëve. (Bjorklund & Causey, 2018).

Megjithatë, mosha optimale për fillimin e shkollës duhet të vlerësohet në mënyrë individuale, duke marrë parasysh zhvillimin e fëmijës dhe faktorët kulturorë e arsimorë të vendit ku jeton. (Suggate, 2009). Në zhvillimin psiko-fizik të fëmijës, studimet dhe hulumtimet e kryera me fokus në përgatitjen e fëmijës për mësim në shkollë kanë identifikuar një moment të përshtatshëm për nisjen e kësaj faze të rëndësishme të jetës. Ky moment i përshtatshëm quhet mosha optimale, në të cilën fëmija, si nxënës i ardhshëm, mund të ketë potencial më të madh për sukses të lartë në përvetësimin e njohurive dhe aftësive të reja. Dërvodeli në librin e tij “Dallimet në suksesin e nxënësve të shkollës fillore të regjistruar para kohe, me kohë dhe pas kohe” thekson se, regjistrimi i fëmijëve në klasën e parë, të shkollës fillore, për ata që janë me moshë 5 e 6 vjet, mbart me vete shumë emocione, gjë që nënkupton fëmijë me temperamente të ndryshme, fëmijë me prejardhje nga kopshti, fëmijë që nuk kanë vijuar asnjë ditë në kopsht, fëmijë me gjendje ekonomike e sociale të ndryshme, fëmijë me prindër, niveli arsimor i të cilëve është i ndryshëm.

Ndoshta asnjë çështje tjetër nuk shfaqet aq shpesh dhe dominuese në diskutimet e prindërve për gatishmërinë për shkollë ose politikat e gatishmërisë së distrikteve shkollore se ajo e moshës në të cilën fëmijët kanë të drejtë (ose u kërkohet) të fillojnë shkollën. Kur prindërit anketohen për gatishmërinë dhe regjistrimin e fëmijëve të tyre në shkollë, një nga pyetjet më të shpeshta që vihet re është nëse fëmija i tyre është shumë i vogël për t’u regjistruar. (West, Hausken, & Collins, DC: 1993).

Mësimdhënia dhe mësimi që u'a ofrojnë fëmijëve në atë kohë mund të mos jetë efektive, pasi që koha optimale ose interesi për të mësuar ka kaluar.

Për më tepër, fillimi i shkollës në një moshë më të vonshme se mosha e kërkuar mund të ketë edhe dëme të caktuara. Me mbështetjen e një psikologu ekspert, mund të përcaktohet mosha më e përshtatshme për edukimin e fëmijës, duke mbështetur zhvillimin e tij të shëndetshëm.



Ky është një ilustrim që tregon një klasë me fëmijë të moshave të ndryshme, ku disa janë në moshën optimale dhe duken të angazhuar, ndërsa të tjerët që kanë filluar më herët duken të hutuar ose të pasigurt.

2.6 Rëndësia e moshës kronologjike dhe zhvillimore për regjistrimin e nxënësve në klasën e parë

Regjistrimi i nxënësve në klasën e parë është një proces që ndikohet nga faktorë të ndryshëm, ku ndër më kryesorët janë mosha kronologjike dhe zhvillimore.

Mosha kronologjike (dita, muaj dhe viti i lindjes), për fëmijën, paraqet kohën prej lindjes e deri me rastin e regjistrimit në shkollë. (Dërvodeli, "Dallimet në suksesin e nxënësve të shkollës fillore të regjistruar para kohe, me kohë dhe pas kohe", 2010). Mosha kronologjike e fëmijës, bashkë me moshën zhvillimore, duhet të merret për bazë, sa të jetë e mundur, sepse janë një parakusht shumë i rëndësishëm që premtojnë, si për fëmijën, ashtu edhe për familjen e për arsimtarin, arritje të suksesit të kënaqshëm në shkollë dhe kudo tjetër. (Dërvodeli, "Zhvillimi historik i institucioneve parashkollore", n.d).

Mosha kronologjike përdoret si kriter bazë në shumicën e sistemeve arsimore për përcaktimin e kohës së regjistrimit në shkollë. Shumica e vendeve rekomandojnë që fëmijët të fillojnë klasën e parë në moshën 6 ose 7 vjeç. (OECD, 2017). Kjo moshë është vendosur bazuar në studime që tregojnë se fëmijët e kësaj grupmoshe kanë arritur një nivel të caktuar të zhvillimit që i lejon të përballojnë sfidat akademike dhe sociale të shkollës. (Lincove & Painter, 2006). Megjithatë, disa studime argumentojnë se mosha kronologjike nuk është gjithmonë treguesi më i mirë për gatishmërinë shkollore, pasi zhvillimi i fëmijëve mund të ndryshojë ndjeshëm Brenda së njëjtës grupmoshe. (Suggate, 2009).

Fëmijët e kësaj moshe kanë të njëjtat aftësi psiko-fizike, por këto aftësi kanë veçori dalluese, në bazë të cilave ndryshojnë nga të tjerët, këto aftësi quhen veti individuale psiko-fizike. (Zuna-Deva A. , Edukimi i parashkollorit në familje , 2003). Gatishmëria për të hyrë në shkollë përfshinë: zhvillimin fizik, zhvillimin e personalitetit e atë social dhe zhvillimin kognitiv. (Vadahi, 2002). Studimet kanë treguar se fëmijët që janë më të pjekur emocionalisht dhe kognitivisht në momentin e regjistrimit kanë një përvojë më të suksesshme në shkollë dhe tregojnë një përfshirje më të madhe në mësim. (Bertram & Pascal, 2016).

Për të siguruar suksesin e nxënësve në klasën e parë, ekspertët rekomandojnë që sistemet arsimore të mos mbështeten vetëm në moshën kronologjike për regjistrim, por të marrin në konsideratë edhe maturinë zhvillimore të fëmijës. (OECD, 2017).

2.6.1 Zhvillimi fizik dhe kognitiv në fëmijërinë e mesme


Fëmijëria e mesme përfshin periudhën prej 6 deri 10-11 vjeç. Këto vite janë të rëndësishme sepse lidhen, nga njëra anë, me fillimin e shkollës dhe, nga ana tjetër, me futjen në periudhën e pubertetit. Fillimi i shkollës fillore është një ndryshim i madh. Një pjesë e fëmijëve që kanë qenë në kopshte parashkollorësh kanë një farë eksperience lidhur me të qenit larg nga shtëpia për një pjesë të madhe të ditës. Kjo e bën më të lehtë përshtatjen me shkollën fillore. Megjithatë, kjo përshtatje nuk është aq e lehtë, sepse niveli i detyrave që duhet të kryejë fëmija është më i ndërlikuar. Tani fëmijës i duhet të përvetësojë në mënyrë më intensive se më parë një sërë shprehish që lidhen me lëndët mësimore, por edhe një sërë shprehish komunikimi dhe bashkëpunimi me moshatarët. Përvetësimi i këtyre shprehive ndikon dukshëm në nivelin e vetëvlerësimit të fëmijës, si dhe në jetën e tij të mëvonshme si i rritur. (Karaj, 2005).

Zhvillimi fizik (karakteristikat e zhvillimit fizik)

Zhvillimi fizik shpreh ndryshimet në cilësitë trupore të individit, në sjelljen lëvizore dhe në proceset fiziologjike. Duhet shtruar pyetja nëse fëmija është aq i zhvilluar fizikisht sa të përballojë ngarkesën e përditëshme shkollore, të kryejë detyrat e shtëpisë. Në qoftë se fëmija nuk është i rritur që të përballojë këto kërkesa, atëherë është i kërcnuar si shëndeti i tij ashtu edhe zhvillimi normal i organizmit. Ai ndjehet i lodhur duke mos qenë në gjendje të ndjekë normalisht mësimet si dhe të kryejë detyrat që i shtron procesi mësimor.

Në këtë drejtim themi se nuk është i kërcnuar vetëm zhvillimi trupor, por edhe ai psikik. Zhvillimin fizik të fëmijës e përcakton mjeku e psikologu. Megjithatë, vetëm mbi bazën e kësaj të dhëne nuk mund të përcaktohet suksesi i tij në shkollë. Shumë fëmijë janë të zhvilluar mirë fizikisht, por këtij zhvillimi nuk i përgjigjet kurdoherë ai psikik. Për këtë arsye pas kontrollit shëndetësor duhet të bëhet edhe testimi psikologjik. (Vadahi, 2002).

Një nga arsytet që fëmijëria e mesme është një fushë jo shumë e studiuar, është se te fëmijët, në këtë periudhë, nuk ndodh ndonjë ndryshim fizik i dukshëm dhe i veçantë.



Një nga arsytet që fëmijëria e mesme është një fushë jo shumë e studiuar, është se te fëmijët, në këtë periudhë, nuk ndodh ndonjë ndryshim fizik i dukshëm dhe i veçantë.

- Rritja fizike është më uniforme. Përmasa e trupit rritet gradualisht.
- Rritja në gjatësi: nga periudha 6 deri në 12 vjeç fëmija shton në gjatësi rreth 20 cm.
- Rritja në peshë: një 6 vjeçar peshon mesatarisht rreth 20 kg. Një 12 vjeçar peshon mesatarisht rreth 39 kg. Kjo rritje në peshë vjen për arsye të rritjes së muskujve dhe qelizave dhjamore në kohën që fëmijët zgjaten dhe hollohen.
- Rënia e dhëmbëve dhe erupioni i dhëmbëve permanentë, është një ndryshim mjaft i ndjeshëm në këtë moshë. Në moshën 5 ose 6 vjeç fëmijët fillojnë të humbasin dhëmbët. Te vajzat kjo ndodh më para se te djemtë. Në moshën 12 vjeç zhvillohen dhëmbët permanentë, të cilat janë më të mëdha. Kjo i jep fytyrës së fëmijës një pamje më të rritur.
- Mielinizimi i neuroneve thuajse kompletohet mes moshës 6 gjer 8 vjeç.
- Në moshën 8 vjeç, truri arrin, thuajse, përmasën e maturimit. Rritet

frekuenca e valëve të trurit dhe kjo shpie në një nivel më të maturuar të aktivitetit të tij. (Karaj, 2005).

Nga këndvështrimi teorik, zhvillimi i fëmijës në këtë periudhë është analizuar nga studiues të ndryshëm. Teoria e zhvillimit kognitiv e Piaget-it dhe teoria e zhvillimit social-emocional e Eriksonit ndihmojnë në kuptimin e ndryshimeve që përjetojnë fëmijët në këtë fazë të jetës.

2.6.2 Zhvillimi kognitiv në fëmijërinë e mesme

Pikëpamja e Piazhës

Gjatë fëmijërisë së mesme, në fushën kognitive, ndodhin ndryshime më të rëndësishme, veçanërisht, në vitet e hershme të kësaj periudhe, në kohën kur fëmija fillon shkollën. Piazhja e vlerëson këtë periudhë po aq të rëndësishme nga pikëpamja kognitive, sa edhe zhvillimin e aftësisë për të përdorur simbole në moshën dy vjeçare. (Karaj, 2005).

Stadi paraoperacional zgjat afërsisht 2 deri në 6-7 vjeç. Sipas Piazhës, fëmijët zhvillojnë mjaft aftësi (p.sh., përdorin simbole), por atyre u mungon aftësia për të realizuar një sërë përgjigjesh mendore logjike më pas fëmija kalon në stadin paraoperacional konkret (afërsisht 7-11 vjeç), kur ai fillon të zotërojë shumë aftësi mendore. (Perolli Shehu, Xhakollari, Hoti, & Kakija, 2019). Sipas Piazhës, në këtë periudhë fëmija zhvillon një sërë rregullash ose strategjish të përgjithshme për të ekzaminuar dhe bashkëvepruar me botën. Piazhja e quajti këtë seri *operacione konkrete*. (Karaj, 2005). Me fjalën *operacion* Piazhja nënkupton çdo seri skemash si kthyeshmërinë, mbledhjen, zbritjen, shumëfishimin, ndarjen, ose rradhitjen e gjërave. Secila prej këtyre skemave është një farë rregulli i brendshëm rreth objekteve dhe marrëdhënieve mes objekteve. Fëmija e kupton tani rregullin se të shtosh diçka, e bën diçka më tepër (më shumë sasi) dhe se, heqja dhe zbritja, e bën atë diçka më pak: ajo kupton se objektet mund t'i përkasin më shumë se një kategorie në të njëjtën kohë dhe që kategoritë kanë lidhje logjike mes tyre. (Karaj, 2005).

Termi *konkret* tregon se fëmijët janë logjikë vetëm gjëra që janë konkrete (fizikisht të pranishme dhe që lidhen ngushtë më përvojën aktuale të fëmijës) dhe jo për gjëra abstrakte apo hipotetike. (Perolli Shehu, Xhakollari, Hoti, & Kakija, 2019). Ky stad karakterizohet nga përvetësimi i disa shprehive konceptuale që e lejon fëmijën të bëjë një manipulim logjik të objekteve.

Pesë vitet e para të jetës, veçanërisht dy të parat, janë më kritikët për zhvillimin e përjetshëm të fëmijës. Gjatë viteve të para të jetës, truri jo vetëm që zhvillohet shumë shpejt, por gjithashtu përjeton një konsolidim të fortë të lidhjeve midis qelizave nervore të hershme ndikojnë në zhvillimin funksional të trurit.

Kjo është arsyeja pse vitet e para të jetës janë të rëndësishme. Kjo vlen jo vetëm për zhvillimin intelektual dhe gjuhësor, por edhe për zhvillimin social dhe emocional, dhe kryesisht ka të bëjë me aftësinë për të krijuar lidhje, për të menaxhuar stresin dhe për të kapërcyer sfidat. Aftësi të tilla socio-emocionale janë themeli për suksesin e mëvonshëm arsimor dhe jetësor. (Stamm, n.d).

Zhvillimi kognitiv përfshin ndryshimet që ndodhin në të menduarin e fëmijëve, në kujtesën e tyre, në të folurin dhe në zgjidhjen e problemeve. Zhvillimi kognitiv lidhet me konceptimin e botës. Në periudhën parashkollore fëmija në fantazinë e tij, në mënyrë të vullnetshme i transformon objektet sipas interesave dhe dëshirave të tij. (Vadahi, 2002). Piazheja e përkufizonte *zhvillimin* si ndërtimin në mënyrë aktive të dijes dhe të nxënët si formimin pasiv të lidhjeve midis dukurive. Ai ishte i interesuar për fushën e ndërtimit të dijes dhe ishte i bindur se zhvillimi konjitiv duhet të vijë përpara të nxënët- fëmija duhet të jetë i “gatshëm”, në pikëpamjen konjitive, për të mësuar. Ai thoshte se “të nxënët është i varur nga zhvillimi dhe jo anasjelltas” (Woolfolk, 2011).

2.6.3 Zhvillimi psikosocial në fëmijërinë e mesme

Zhvillimi i konceptit për veten

Në këtë moshë fëmijët kanë një koncept më kompleks për tiparet e veta fizike, mendore dhe tiparet e personalitetit të tyre. Fëmijët krahasojnë veten me moshatarët: “Unë jam më i mirë se X në lexim, por jam më i dobët në artitmetikë”. Koncepti për veten, tashmë më i zhvilluar, shërben si një filtër me anë të të cilit fëmija vlerëson sjelljen e vet dhe të të tjerëve. Por duhet ditur se koncepti për veten nuk është gjithmonë i saktë. Fëmijët mund të kenë një mendim pozitiv për kompetencat e tyre, sesa nga sa kanë në të vërtetë. Në këtë shkallë, vetëvlerësimi është i lidhur me suksesin e fëmijës në shkollë. Fëmija që shkon në shkollë, ka edhe një vetëvlerësim të lartë dhe e kundërta. Vetëvlerësimi i fëmijës varet edhe nga faktorë të tjerë: fakti sa vlerësohet fëmija nga familja, nga moshatarët dhe mjedisi përreth fëmijës. Kështu që, ka fëmijë që zhvillojnë një vetëvlerësim të lartë edhe pse mund të mos kenë rezultate të larta në mësim.

Në fëmijërinë e mesme, marrëdhëniet me moshatarët zhvillohen dukshëm dhe lozin një rol të madh në zhvillimin social dhe të personalitetit të fëmijës. (Karaj, 2005).

Zhvillimi i personalitetit të fëmijët dhe zhvillimi social i tij, përmban në vetvete ndryshimet në personalitetin e fëmijës, në funksionimin e tij social dhe në ndjenjat dhe emocionet. Flitet nëse fëmija ka mundësinë dhe pavarësinë për t'u treguar i gatshëm të largohet nga shtëpia dhe t'i nënshtrohet procesit mësimor që realizohet në shkollë, porositë të mësuesit dhe mundësinë për t'u përfshirë në punët në grup. Fëmija i zhvilluar nga ana sociale tregon interes për moshatarët e tij, e kërkon shoqërinë e tyre dhe është i gatshëm për të bashkëpunuar me to. (Vadahi, 2002).

Zhvillimi i aftësive sociale: fëmijët mësojnë të shohin veten rreth të tjerëve në mjedisin e klasës. Në këtë mjedis, ndërsa ndjenja e tyre për veten zhvillohet, ata gjithashtu fillojnë të fitojnë aftësi sociale si ndarja, bashkëpunimi dhe komunikimi me fëmijët e tjerë. Kontributi më i rëndësishëm i ndërveprimit social për fëmijën është se ai ushqen aftësi që nuk mund të mësohen, por zhvillohen në mënyrë spontane si rezultat i mjedisit.

Zhvillimi gjuhësor pasqyrohet përmes rritjes cilësore dhe sasiore të aftësisë së fëmijëve për të perceptuar e përdorur tingujt, për të zgjeruar fjalorin, për të njohur e përdorur struktura të ndryshme të fjalive, për të dalluar kuptimet e fjalëve, të fjalive dhe përmes rritjes së aftësisë së tyre për të marrë pjesë gjallërisht në situata të ndryshme komunikative.

Studimet tregojnë se fjalori aktiv i fëmijëve të moshës 6 vjeç nuk është shumë i pasur. Studiuesit japin shifrat nga 2500-2600 fjalë, të cilat fëmijët i përdorin aktivisht, ndërsa fjalori i tyre pasiv është shumë i pasur. Është e sigurt se ekziston një lidhje midis zhvillimit të të folurit të fëmijës dhe shkrimit fillestar. Niveli i zhvillimit të të folurit të fëmijës, si kusht për përvetësimin e të lexuarit dhe të të shkruarit, është ndoshta më i rëndësishëm sesa aftësia njohëse e tij. (Beci, 2006). Fëmijët që nuk janë të zhvilluar, përkatësisht që nuk e kanë arritur gatishmërinë me kohë, për nisje në shkollë, pavarësisht se në çfarë moshe janë dhe pavarësisht sesi e shohin dispozitat ligjore këtë problem, nuk janë të gatshëm për nisje në shkollë. "Këta fëmijë (nxënës) nuk përparojnë në masë të nevojshme dhe, shpesh, e vënë mësuesin para problemeve të mëdha, të cilat ai nuk mund t'i zgjidhë, as me durim, as me detyrim". (Dërvodeli, "Zhvillimi historik i institucioneve parashkollore", n.d).

Megjithatë, këndvështrimet e mëparshme teorike janë më tepër një dimensionale dhe nënkuptojnë se gatishmëria për shkollë është më e përqendruar te fëmijët dhe përcaktohet më së miri nga aftësitë e tij/saj. (Matthews, 2008). Klima e përshtatshme psikologjike është rezultat i marrëdhënieve të harmonizuara dhe humanizuara interpersonale si në familje ashtu edhe në klasë, përkatësisht në tërë shkollën. Manifestohet në krijimin e kushteve të volitshme shpirtërore për zhvillimin e mbarë e të lirë intelektual, emocional, kulturor dhe social të nxënësit ose më mirë të themi për zhvillimin e gjithëanshëm të personalitetit të tij socialist. Klima e përshtatshme psikologjike krijon marrëdhënie të sinqerta dhe intime në mes të arsimtarit dhe të nxënësve në veçanti të nxënësve shëndetligë e të nxënësve introvertë. (Brada, 1984).

Punën arsimore nxënësi e përjeton psikologjikisht në mënyra të ndryshme, po kryesisht në mënyrë intelektuale dhe emocionale. Përjetimet intelektuale kanë të bëjnë me proceset intelektuale të nxënësit që mëson. Përvetësimi i diturive nuk varet vetëm prej zhvillimit të proceseve intelektuale, po edhe nga përshtatja e diturive me moshën, me fuqitë dhe me aftësitë e nxënësve. (Bekteshi, 2009).

2.7 Faktorët që ndikojnë në vendosjen e moshës optimale për regjistrimin e nxënësve në klasën e parë

Gatishmëria për shkollë është një temë komplekse dhe e rëndësishme që kërkon konsiderimin e një sërë faktorësh për t'u kuptuar dhe vlerësuar plotësisht.

Zhvillimi i personalitetit në përgjithësi, si dhe ai i fëmijës së kësaj moshe, në veçanti, bëhet nën ndikimin e faktorëve të lindur, faktorëve të mjedisit të jashtëm, edukatës dhe aktivitetit të vetë individit. (Zuna-Deva A. , Edukimi i parashkollorit në familje , 2003).

Në shumë vende, politika për moshën e regjistrimit ndryshon, duke u bazuar në faktorë të ndryshëm kulturor, social dhe ekonomik. (Sharp, 2002).

Faktorët që ndikojnë në regjistrimin e fëmijëve në klasën e parë janë:

- ✓ Faktorët biologjikë dhe psikologjikë
- ✓ Faktorët familjarë dhe socialë
- ✓ Faktorët arsimorë dhe politikë

2.7.1 Faktorët biologjikë dhe psikologjikë

Zhvillimi i trurit dhe aftësitë njohëse ndikojnë në gatishmërinë për të mësuar. (Diamond, 2013). Në qoftë se në aspektin e zhvillimit psikik bëjmë krahasimin e moshatarëve do të konstatojmë se disa prej tyre zhvillohen më shpejt e disa të tjerë më ngadalë. Ekzistojnë shumë faktorë që përcaktojnë këto ndryshime individuale. Në këtë drejtim duhen marrë parasysh infeksionet e ndryshme të cilët ndikojnë në gjendjen shëndetësore të fëmijëve, ndikimi i dispozitave, ndikimi i mjedisit në të cilin rriten, nxitjet e ndryshme, si dhe mundësitë për zhvillim, metodat e punës së edukimit që përdorin prindërit, etj. (Vadahi, 2002).

(Vadahi, 2002), po ashtu thekson se, zhvillimi fizik përcaktohet nga mjeku. Përveç gjendjes fizike të fëmijës merren parasysh edhe normat standarte të zhvillimit të personalitetit. Të dhëna për zhvillimin social dhe emocional të fëmijës mund t'i marrim nga prindërit duke i pyetur si sillet fëmija në situata konkrete, p.sh., a vishet vetë, sa kohë mund të kalojë në një grup fëmijësh, si u përgjigjet pyetjeve të prindërve dhe kërkesave të tyre, etj.

Rëndësi të veçantë për përgatitjen e fëmijëve 6-vjeçarë për klasën e parë ka forcimi e zhvillimi i proceseve psikike njohëse në kopsht (të ndijimeve, perceptimeve, përfytyrimeve, etj).

Gjithashtu, që fëmijët, shkollarë të klasës së parë, të jenë të motivuar dhe rezultativë në shkollë kërkohet që gjatë zhvillimit të aspekteve të shumta që realizon kopshti të realizojë zhvillimin e veprimtarisë mendore, të aftësisë përgjithësuese, gjykimeve, aftësinë për të gjetur shkaqet e dukurive të realitetit (jo vetëm të atyre që janë të dukshme). (Vadahi, 2002).

Pjekuria emocionale dhe sociale janë faktorë kyç për të përballuar sfidat shkollore.

2.7.2 Faktorët familjarë dhe socialë

Prindërit luajnë një rol të madh në vendimin për regjistrimin e hershëm ose të vonshëm të fëmijës.

Familja ka funksion edukativ/pedagogjik. Nis një jetë të re dhe me këtë nis edhe procesi i edukimit, i cili zgjat aq sa edhe jeta e njeriut. Fillesat e edukimit të njeriut nisin në familje dhe vazhdon ky funksion por me intesitet e cilësi tjetër, edhe në periudhat e tjera të jetës. Familja ka e duhet ta forcojë interesimin dhe gatishmërinë për të krijuar kushte sa më të volitshme për zhvillimin e tërësishëm të potencialitetit të lindur të fëmijës, në njërin anë dhe të mundësojë e të aftësojë fëmijën t'i shfaqë aftësitë e tij maksimalisht, në anën tjetër. Familja krijon kushte për jetë të shëndetshme dhe zhvillim fizik të fëmijës. Angazhohet dhe ka zakonisht ambicie për përparim të fëmijës në mësim dhe jetën shkollore. (Zuna-Deva, 2009).

Për fëmijët e vegjël, prindërit janë kujdestarët më të rëndësishëm. Ata janë përgjegjës për kujdesin ndaj fëmijëve të tyre si dhe për zhvillimin dhe sugjerimet edukative brenda dhe jashtë familjes. Në veçanti, burimet e ulëta arsimore, burimet e kufizuara financiare dhe një mjedis social jombështetës çojnë në një sërë stresesh që e bëjnë të vështirë për prindërit të mbështesin plotësisht zhvillimin arsimor dhe edukimin e fëmijëve të tyre. (Edelmann, Beeler, Krienbühl, Claudia, & Fabienne, 2019).

(Epstein, 2001), argumenton se, familjet e nxënësve nuk janë të njëjta. Disa nxënës jetojnë me të dy prindërit, të tjerë kanë vetëm njërin prind, disa prindër punojnë, ndërsa disa të tjerë janë të papunë. Pra, ka një mori llojesh, karakteristikash dhe situatash të nxënësve, familjeve, shkollave dhe komuniteteve. Sipas një studimi të bërë nga Prof. Dr. Margrit Stamm, konstatoi se për fat të mirë, 75% e fëmijëve lindin në familje që mund t'u ofrojnë atyre kujdesin dhe mbështetjen e nevojshme për zhvillim të shëndetshëm. Burimet arsimore të prindërve kanë një ndikim në orientimin arsimor dhe për rrjedhojë luajnë një rol vendimtar në përcjelljen e mundësive arsimore tek fëmijët e tyre.

Faktorët e mëposhtëm në veçanti kanë një ndikim negativ:

- Mungesa e kualifikimeve shkollore dhe/ose profesionale të prindërve, veçanërisht të nënës.
- Mungesa e njohurive se si fëmijët mund të stimulohen në një mënyrë të përshtatshme për moshën.
- Komunikim i mrekullueshëm dhe mbështetje gjuhësore brenda familjes.
- Më pak përshtatje mes sugjerimeve të familjes dhe kërkesave të shkollës, pak njohuri.
- Kanë përvoja të këqija arsimore.

Janë shumë faktorë brenda ambientit shtëpiak që mendohet se influencojnë të dy aspektet e zhvillimit social dhe kognitiv të fëmijëve. Ambienti i shtëpisë, besohet se ndikon në aspektin kognitiv duke u vërejtur në intelegjencë, letërsi, lexim, dhe arritje të aftësive matematikore. Kompetenca sociale me bashkëmoshatarë dhe me të rritur është e influencuar nga disa faktorë brenda shtëpisë. Disa nga treguesit më domethënës në shtëpi që mendohet se ndikojnë pozitivisht në përgatitjen e fëmijëve për shkollë përfshijnë burime të përshtatshme për stimulim kognitiv dhe mundësitë për të mësuar nga komuniteti, siç janë udhëtimet familjare, vizitat në kopshtin zoologjik. (Landry, Smith, R., & Guttentag, 2008).

Stimulimi i nxënësve duke u ofruar atyre stimuj të pasur në moshë të hershme, para se të fillojnë shkollën fillore, do të mbështesë pozitivisht suksesin e tyre në fazat e mëvonshme.

Zhvillimi kognitiv dhe socio-emocional, si dhe përvojat që fëmijët kanë në kontekstin e familjes së tyre dhe, nëse është e nevojshme, në institucione arsimore si çerdhe, familje ditore ose grupe lojërash luajnë një rol të rëndësishëm në tranzicion. (Edelmann, Beeler, Krienbühl, Claudia, & Fabienne, 2019). Regjistrimi i parakohshëm në shkollë. Në kohë të fundit gjithnjë e më shpesh ka raste që fëmijët të regjistrohen në shkollë shumë herët, pa i mbushur shtatë vjet, madje edhe gjashtë. Për shfaqjen e kësaj dukurie ka disa arsye. Njëra prej tyre është zënia me punë e të dy prindërve, të cilët nuk kanë mundësi përditë të kujdesen për fëmijët e tyre. Për shkak të kësaj dukurie sot kemi në shkollat tona nxënës në një klasë me dallime në moshë, prej një a dy vjet. Këto dallime, në vështrim të parë, nuk duken aq të mëdha, por në thelb janë të mëdha.

Përmbajtjet programore të shumta e të vështira, që janë caktuar për nxënës të moshës shtatëvjeçare janë ngarkesë shumë e madhe për nxënësit e regjistruar në shkollë para kohe. Prandaj edhe ky është faktor që disa nxënës janë të mbingarkuar dhe nuk mund të tregojnë sukses në shkollë. (Bekteshi, 2009). Duke qenë se fëmijët hyjnë në sistemin arsimor me kërkesa shumë të ndryshme përsa i përket moshës së tyre, zhvillimit të tyre kognitiv dhe socio-emocional, prejardhjes së tyre familjare dhe përvojave të tyre në institucionet parashkollore, konsiderohet e rëndësishme që prindërit, specialistët pedagogjikë dhe mësuesit në shkollat e detyrueshme mbështesin tranzicionin e fëmijëve. Në këtë kontekst, vëmendje i kushtohet edhe asaj se çfarë strukturash duhet të krijohen në mënyrë që fëmijët të kalojnë me sukses në sistemin arsimor dhe duke e kthyer kështu hyrjen në shkollë në një mundësi për të gjithë.

Sipas një modeli të tranzicionit i cili u zhvillua në Institutin Shtetëror për Edukimin e Fëmijërisë së Hershme në Mynih, ai u bazua në qasjen ekopsikologjike, modelin e gatishmërisë për shkollë, teoritë kërkimore të stresit dhe teorinë e ngjarjeve kritikë të jetës. Kjo merr një perspektivë sistematike që e bën të qartë se grupe të ndryshme njerëzish, ndërveprimet dhe bashkëpunimet e tyre, si dhe kushtet institucionale dhe sociale ndikojnë në procesin e tranzicionit. Në këtë mënyrë, tranzicioni kuptohet si një detyrë zhvillimore që mund të mbështetet në mënyrë optimale nga një mjedis mësimor bashkëkonstruktiv. (Edelmann, Beeler, Krienbühl, Claudia, & Fabienne, 2019).

Zuna-Deva, në librin e saj “Partneriteti Shkollë-Familje-Komunitet” 2009 partneritetin midis faktorit shkollë-familje-komunitet e cilëson si një proces të gjatë dhe të ndërlikuar. Si proces aktiv e i vazhdueshëm nis që nga parapërgatitja për nisje në shkollë. Respektivisht nga momenti i futjes së fëmijës në shkollë apo në nivelet e reja, zgjat gjatë tërë procesit të shkollimit deri në përfundimin e shkollimit e në rrethana të veçanta edhe pas përfundimit të shkollimit të fëmijës/nxënësit.

Faktorët në partneritet në fokus prioritar të bashkëpunimit duhet të kenë fushat e ndryshme si:

- Fushat e shëndetit të fëmijës/nxënësit
- Fushat e intelektit të fëmijës/nxënësit
- Fusha e socializimit dhe moralitetit të fëmijës/nxënësit
- Fusha e krijimtarisë artistike
- Fusha e kulturës së punës.

2.7.3 Faktorët arsimorë dhe politikë

Politikat arsimore përcaktojnë kufirin minimal dhe maksimal të moshës për regjistrim. (OECD, 2017). Për pranim në klasën e parë si kriter përcaktues shërben moshë. Në shkollë pranohen ata fëmijë të cilët deri më 31 gusht kanë mbushur moshën 6 vjeç, po kështu edhe ata të cilët deri në fund të atij viti kalendarik do të jenë në këtë moshë. Kriteri bazohet në një fakt të pranueshëm se të gjithë fëmijët e moshës 6-vjeç e gjysmë kanë arritur një nivel të tillë të zhvillimit fizik dhe psikik që të mund të realizojë kërkesat e programit mësimor.

Kurrikula shkollore duhet të përshtatet me nivelin e zhvillimit të fëmijëve për të siguruar një tranzicion të lehtë nga arsimi parashkollor në atë fillor. (Diamond, 2013).

2.8 Çka përfshin Gatishmëria për shkollë ?

Gatishmëri për klasë të parë: është një term i gjerë i cili përfshinë pjekurinë intelektuale, sociale dhe atë emocionale. Gatishmëria është një shkallë në zhvillimin e fëmijës kur ai mund të mësojë lehtë, në mënyrë efektive dhe pa shqetësime emocionale. Nuk mund të jetë një pikë definitive e zhvillimit, sepse zhvillimi është proces i vazhdueshëm gjatë gjithë jetës. Më tepër është një gjendje që tregon se fëmija është i gatshëm për të mësuar. (Joey, 2003).

Problemi i gatishmërisë a i pjekurisë së fëmijëve, për nisje në shkollë, nuk është një çështje e thjeshtë, por një problem që kërkon një përkujdesje dhe një përkushtim të madh, si të prindërve, ashtu edhe të faktorëve të tjerë shoqërorë. Kështu, sot, nxënësi në shkollë nuk është i detyruar vetëm të mësojë, por edhe t'i përshtatet shoqërisë së një numri të madh të moshatarëve, t'i zbatojë këshillat e arsimtarit, përkatësisht të arsimtarëve, si dhe t'i përmbahet disiplinës së caktuar shkollore.

Problemi i gatishmërisë, përkatësisht i pjekurisë së fëmijës për shkollë, deri fare vonë, në shkollë vlerësohej, të shumtën, në bazë të moshës kronologjike dhe, përkitazi me këtë, mendohej paraprakisht se fëmija është i pjekur për shkollë kur të mbushë një numër të caktuar të viteve të tij (7 vjet), si parashihet me dispozitat ligjore të shkollimit fillor thekson në librin e tij: (Dërvodeli, Januz, 2010). Sipas të dhënave pedagogjike dhe psikologjike fëmijët e moshës parashkollore janë të aftë për të filluar në shkollë si dhe të ballafaqohen me problemet që i presin në klasë të parë, vetëm atëherë kur konstatohet se fëmijët janë të pjekur në pikëpamje fizike, psikologjike dhe sociale. Fëmija për të filluar në shkollë medoemos duhet të jetë i shëndoshë, me gjatësi dhe peshë të duhur sipas të gjitha proporcioneve, të mos ketë vëshitrësi për lëvizje, të mos ketë ndonjë defekt në të parë dhe të dëgjuar, të mund t'i përballojë rrugës të cilën duhet ta kalojë në këmbë prej shtëpisë në shkollë dhe anasjelltas. Andaj të jetë në gjendje t'i zgjidhë me sukses problemet e jetës së përditshme sikurse edhe shumica e moshatarëve të tij. Ky është edhe njëri prej kriterëve primare meqë mosha mentale medoemos duhet të jetë në përputhshmëri me moshën kalendarike. (Haliti, 2003). Për shkak të dallimeve në konceptimin e gatishmërisë për shkollë, gama e këndvështrimeve përfshin përkufizime që fokusohen në aftësitë individuale dhe faktorëve që kontribuojnë në gatishmërinë e fëmijëve në shkollë. (Matthews, 2008).

Tradicionalisht, konceptualizmi i gatishmërisë për shkollë është bazuar në supozimin se ekziston një grup i paracaktuar aftësish që të gjithë fëmijët kanë nevojë përpara se të hyjnë në shkollë. (NAYEC, 1995). Aftësia e shkollës ose ajo që duhet të dinë dhe të jenë në gjendje të bëjnë fëmijët që të marrin pjesë me sukses në orët fillestare në shkollën fillore është e rëndësishme për suksesin e tyre të movonshëm në shkollë dhe në jetë. Ky term synon të shprehë se termi “gatishmëri për shkollë”, i cili përdorej shpesh në të kaluarën, tani është vjetëruar. Gatishmëria për shkollë nuk përcaktohet vetëm gjenetikisht, por edhe rezultat i historisë së mëparshme të të mësuarit dhe zhvillimit të fëmijës dhe ndikimeve të mjedisit të fëmijës. (Stamm, n.d).

Prof. Dr. Margrit Stamm nga Departamenti i Shkencës së Edukimit vlerëson se Gatishmëria për shkollë është më shumë se çfarë dinë dhe mund të bëjnë fëmijët. Mënyra se si mbështetet një fëmijë, si kujdeset për të, luan një rol të madh në zhvillimin e gatishmërisë për shkollë. Fëmijët nuk rriten në vakum. Këto aftësi përcaktohen vetëm gjenetikisht. Si gjenet, ashtu edhe mjedisi janë të përfshirë në atë që një fëmijë mund të arrijë dhe në rrugën në të cilën ai ose ajo bëhet gati për shkollë. Prandaj, fëmija nuk është viktimë e gjeneve të tij. Përkundrazi, ai ndërvepron me mjediset e tij të ndryshme dhe merr pjesë aktive në këtë proces.

Ajo tradicionalisht, gatishmërinë për shkollë e sheh si shumëdimensionale. Si rezultat, ai nuk përfshin vetëm atë që fëmijët mund dhe dinë. Një hyrje e suksesshme në shkollë manifestohet si nga fëmija dhe familja e tij, ashtu edhe nga shkolla:

- Së pari, fëmija ka njohuri dhe aftësi të mjaftueshme, përvetësimi i të cilave është bërë i mundur nga familja e tij/saj dhe mjedisi jashtë familjes. Të bëhesh gati për shkollën përfshin gjithashtu, aspekte emocionale dhe sociale, të tilla si të jesh kurioz, të jetë në gjendje të luajë dhe të punojë me të tjerët, të ndjekë udhëzimet dhe të jetë në gjendje të përballet me ndjenjat. Përveq kësaj, ekziston një nivel i mjaftueshëm i njohurive të mëparshme gjuhësore dhe matematikore.
- Së dyti, shkolla përpiqet të bëhet gati për fëmijët. Kjo reflektohet në masën në të cilën i mundëson fëmijës të zhvillojë më tej aftësitë e tyre për të ndjekur. (Stamm, n.d).



2.8.1 Gatishmëria shkollore në diskutimin edukativo-psikologjik

Kuptimi i gatishmërisë për shkollë ka ndryshuar rrënjësisht gjatë 60 viteve të fundit. Që në vitet 1960, u pranua se aftësitë shkollore duhet parë në lidhje me kërkesat e shkollës. Sipas të kuptuarit aktual, nga perspektiva e ekosistemit, përveç fëmijës dhe nivelit të tij të zhvillimit, duhet të merren parasysh edhe kërkesat e shkollës, mjedisi parashkollor dhe familjar i fëmijës dhe kërkesat e shoqërisë në tërësi. Kur fëmijët janë gjashtë vjeç e gjysmë dhe janë gati të fillojnë shkollën, qëllimi për t'u mësuar fëmijëve bazat e leximit dhe shkrimit është e vetmja detyrë që vlerësohet si “më pak e rëndësishme” – njëzëri nga nënat dhe edukatorët, me arsimin profesionistët e konsiderojnë këtë edhe më pak të rëndësishme.

Përgatitja për shkollë shihet si një detyrë “e rëndësishme” e kopshtit. Kjo mund të shpjegohet me faktin se edukatorët preferojnë t'u mësojnë fëmijëve synimet e tyre mësimore dhe përgatitjen për shkollën nëpërmjet masave të rastësishme në jetën e përditshme. Aftësia e fillestarëve të shkollës për të shkruar në shkollë varet kryesisht nga kërkesat specifike të të mësuarit të fëmijës, të tilla si aftësia për të numëruar deri në 20 ose më shumë dhe njohja e alfabetit. (Pohlmann-Rother, Kratzmann, & Faust, 2011). Nuk janë vetëm aftësitë gjuhësore dhe të kuptuarit e hershëm të numrave që janë të rëndësishme për fillimin e shkollës. Aspektet fizike, sociale, emocionale dhe shëndetësore gjithashtu kanë rëndësi. (Stamm, n.d). Aftësia për të shkruar në shkollë dhe rrjedhimisht një hyrje e suksesshme në shkollë manifestohet në dy mënyra: së pari, në faktin se një fëmijë ka njohuri dhe aftësi të mjaftueshme, përvetësimi i të cilave i është bërë i mundur nga familja e tij dhe, nëse është e nevojshme, mjedisi jashtë familjes; së dyti që shkolla të bëhet e përshtatshme për fëmijët dhe t'u mundësojnë atyre të zhvillojnë më tej aftësitë e tyre për të ndjekur shkollën. (Stamm, n.d).

Problemi i gatishmërisë për të hyrë në shkollë është i rëndësishëm për faktin se në klasën e parë pranohen fëmijët nën moshë 7- vjeç dhe synohet që të gjithë për një periudhë kohore, derisa të mbarojnë shkollën fillore. Për të realizuar këtë qëllim është mirë që pranimi i fëmijëve në shkollë të bëhet pasi të kenë arritur nivelin përkatës të zhvillimit fizik e psikik. Në qoftëse se ky nivel zhvillimi (*zhvillimi shpreh ndryshimet fizike, konjitive, dhe karakteristikat e personalitetit të një individi*) i fëmijës nuk është i harmonizuar me kërkesat e shkollës atëherë ata do të kenë vështirësi në veprimtarinë mësimore. (Vadahi, 2002).

2.8.2 Gatishmëria për shkollë sipas pikëpamjes së psikologëve dhe pedagogëve

Specialistët e përfshirë në edukimin e fëmijëve, si: pedagogu, psikologu, mjeku, sociologu duhet të dinë si të promovojnë zhvillimin dhe të nxënit e fëmijëve. Të dish të bësh këtë kërkon të njohësh dhe të kuptosh karakteristikat dhe nevojat e tyre si dhe të njohësh ndikimet e shumëllojshme në zhvillimin dhe të nxënit e fëmijëve. (Morrison, 2011).

Përdorimi i dikotomisë së Kaganit për të shpjeguar “gatishmërinë” e fëmijëve përfshin moshën kronologjike, perspektivat e maturimit dhe zhvillimit. Mosha kronologjike e fëmijëve përdoret shpesh si bazë për përcaktimin se kur duhet të regjistrohen fëmijët në shkollën formale. (Matthews, 2008). Likurgu, Platoni dhe Aristoteli mendonin se mosha më e përshtatshme është 6-, përkatësisht 7 vjeçare. Kjo ide gjeti shprehje në praktikën shkollore në Spartë, në Athinë e, më vonë, edhe në organizimin mësimor në Perandorinë e fuqishme të Romës, ku nxënësit merreshin në procesin mësimor në moshën 7-vjeçare. (Dërvodeli, Januz, 2010).

Në vitet e para të shkollës nxënësit zhvillojnë atë që Eriksoni e quan zelli për punë. Ata fillojnë të shohin lidhjen midis këmbënguljes dhe kënaqësisë së një pune të përfunduar. Kjo është gjithashtu periudha kur nxënësit fillojnë të mundin mjedisin fizik me veprime konkrete. Loja i kënaqi ata më parë, por tani ata duan të bëjnë vetë punë produktive dhe janë fizikisht dhe mendërisht për të. Kjo periudhë e sjell fëmijën në përfshirje të drejtpërdrejtë me botën e të rriturve për punë. Por, për fëmijët në shoqëritë moderne, shkolla dhe mjedisi përreth i ofrojnë fëmijës një grup sfidash të reja që duhet të baraspeshohen me ato në shtëpi. (Musai, 1999).

Sipas Eriksonit, gjatë viteve të para të shkollës, fëmijët duhet të përvetësojnë shprehitë e shkrimit, leximit, aritmetikës si dhe një sërë shprehish sociale. Nëse fëmijët arrijnë përvetësimin e tyre dhe nëse këto suksese vlerësohen prej të tjerëve përreth, te fëmija zhvillohet një sens zelli për punë, (punëdashësia). Në të kundërt, nëse fëmijët arrijnë rezultate të ulta në përvetësimin e shprehive të përmendura më sipër dhe nëse ata krahasohen vazhdimisht për të keq me të tjerët që kanë rezultate të larta, atëherë ata zhvillojnë sensi e inferioritetit. (Karaj, 2005).

Sipas pedagogëve, mosha e rekomanduar, për fillimin e shkollës është nga 6 deri në 7 vjeç

2.9 Përgatitja e fëmijëve për klasën e parë

Problemi i përgatitjes së fëmijëve në shkollë ka herë na ka përcjellë, po na përcjell dhe me siguri do të na përcjellë edhe më tej nëse nuk ndërmirret diç më tepër se deri tani në këtë drejtim. Një barrë e rëndë për përgatitjen e fëmijëve për shkollë, përveç familjes i takon edhe enteve parashkollore të cilat në mënyrë më të organizuar dhe programuar i përgatisin fëmijët e moshës parashkollore për të filluar në shkollë pa ndonjë vështirësi që çon peshë.

Përgatitja e fëmijëve për shkollë është një proces shumëdimensional që përfshin zhvillimin kognitiv, social, emocional dhe fizik të fëmijës, si dhe mbështetjen e mjedisit familjar dhe shoqëror. Ky proces ndikon drejtpërdrejtë në suksesin akademik dhe përshtatjen e fëmijëve me kërkesat e arsimit formal. (UNESCO, 2012). Përgatitja e duhur para hyrjes në shkollë ka treguar se ndikon pozitivisht në performancën afatgjatë të fëmijëve dhe zvogëlon pabarazitë në arsim. (OECD, 2017).

2.9.1 Komponentët kryesorë të përgatitjes për shkollë

1. Zhvillimi kognitiv

Zhvillimi kognitiv është një nga aspektet kyçe të përgatitjes për shkollë, pasi aftësitë e hershme gjuhësore dhe matematikore janë tregues të rëndësishëm të suksesit akademik. (Duncan, et al., 2007). Fëmijët që kanë përvojë me leximin, numrat dhe konceptet bazë para hyrjes në shkollë përshtaten më lehtë dhe arrijnë rezultate më të mira gjatë viteve të para të shkollimit. (Suggate, 2009).

2. Zhvillimi social dhe emocional

Aftësitë sociale dhe emocionale, si vetëkontrolli, ndërveprimi me të tjerët dhe ndërtimi i marrëdhënieve pozitive, janë të rëndësishme për suksesin shkollor. (Ladd, 2003). Studimet tregojnë se fëmijët që hyjnë në shkollë me aftësi të mira sociale kanë një përvojë më pozitive dhe më pak probleme sjellore gjatë tranzicionit nga parashkollori në shkollën fillore. (Rimm-Kaufmann, Pianta, & Martha, 2000). Përgatitja psikologjike dhe emocionale e fëmijëve për ndryshimin nga mjedisi parashkollor në atë shkollor është po aq e rëndësishme sa përgatitja akademike. Mësuesit dhe prindërit duhet të ndihmojnë fëmijët të ndihen të sigurt dhe të motivuar për të mësuar. (Raver, 2002).

3. Zhvillimi fizik dhe shëndeti

Shëndeti fizik dhe aftësitë motorike ndikojnë në mënyrën se si fëmijët përfshihen në aktivitete shkollore. Fëmijët që kanë zhvillim të mirë motorik dhe aftësi për të kryer detyra të thjeshta vetëkujdesi, si veshja dhe përdorimi i mjeteve shkollore, përshtaten më mirë me ambientin shkollor.

4. Mjedisi familjar dhe ndikimi i tij

Prindërit dhe kujdestarët kanë një rol kyç në përgatitjen e fëmijëve për shkollë. Leximi i librave me fëmijët, nxitja e kuriozitetit dhe krijimi i një ambienti të pasur me stimuj edukativ ndikon në zhvillimin e tyre. E rëndësishme për fëmijën që do të shkojë në shkollë, është formimi jo vetëm i shprehive të sjelljes së kulturuar, por kthimi i tyre në zakone, që këto rregulla të bëhen normë e sjelljes së tyre. (Vadahi, 2002).

Mësuesi duhet ta njohë, ta kuptojë edhe ta pranojë teorinë për mënyrën e të nxënës të fëmijëve. Kur mësuesi e njeh dhe e pranon teorinë për zhvillimin e fëmijëve, atëherë ai e di se nxënës kanë stile të ndryshme të të nxënës dhe ai duhet ta përshtatë mjedisin për të nxënës sipas nxënësve, të ofrojë më shumë opsione brenda klasës edhe të planifikojë aktivitete të cilat, përveç faktit se do të jenë në përputhje me programin mësimor, po gjithashtu do t'i takojnë stilet e ndryshme të të nxënës të fëmijëve, dhe me anë të kësaj do të krijohet strategji e suksesshme për përmirësim të të nxënës individual. (Burke, Kiranxhiska, & Llazzarevski, n.d).

Mësuesit duhet pasur parasysh se çdo nxënës është individë i veçantë, produkt i një mjedisi kulturor, me temperament e gjendje shëndetësore të ndryshme, dhe përfundimisht, është një person i veçantë. Këto janë faktorë të cilat ndryshohen gjatë rritjes dhe zhvillimit të nxënës. Ekzistojnë skema të caktuara për zhvillimin. Në këto skema ka dallime të gjera normative të zhvillimit. Për shembull, një nxënës gjashtë vjeçar ndoshta edhe mund të lexojë si nxënës i klasës së tretë, por gjithsesi tek ai do të mbetet nevoja për ta treguar nxitjen e tij “për të qenë i pari”, që është një gjë tipike për nxënës gjashtë vjeçar. Disa nxënës sillen në mënyrë më të arrirë në moshën e vet, disa nxënës zhvillimi kognitiv e tejkalon zhvillimin shoqëror, kurse te disa nxënës rasti nuk është i tillë. Mosha zhvilluese është moshë kur nxënës zhvillohet në aspektin shoqëror, kognitiv, fizik dhe gjuhësor. Kjo është e ndryshme nga mosha e vërtetë e nxënës. Duhet gjetur dallimet në nivelet zhvilluese mes nxënësve të së njëjtës moshë dhe gjithmonë të kihet parasysh ato faktorë për zhvillim, për t'u ndihmuar secilit nxënës që t'i arrijë potencialet e veta. (Burke, Kiranxhiska, & Llazzarevski, n.d).

Në fazën e parë të nxënës, që fillon menjëherë pas lindjes e deri sa t'i mbushë shtatë vjet kur fëmija nisat në shkollë, mësimi është jo i qëllimshëm, spontan, i natyrshëm, i paplanifikuar, pa sistem, pa qëllim dhe i padetyrueshëm. Në këtë periudë me mësim nuk mbingarkohen proceset intelektuale, sepse fëmija mëson kurdo, si do dhe sa do, sipas kërkesave, dëshirave dhe mundësive të veta. Faza e dytë, e cila përfshin periudën e shkollimit, në të cilën përveç mësimi të natyrshëm, spontan dhe të paqëllimshëm, ekziston edhe mësimi i qëllimshëm, me plan të posaçëm, me sistem dhe me pikësnyime të caktuara, prandaj ky lloj mësimi quhet mësim shkollor. (Bekteshi, 2009).

Gjatë një pyetjeje të parashtruar nga Prof. Dr. Margrit Stamm se: Çfarë duhet të jenë të aftë të bëjnë dhe të dinë fëmijët kur fillojnë shkollën që të marrin pjesë me sukses në mësimet fillestare në shkollën fillore?

Ajo arriti në një përfundim se është e qartë se kjo e ashtuquajtur aftësi shkollore ka një ndikim vendimtar në suksesin e mëvonshëm shkollor dhe jetësor. Prandaj, fëmijët duhet të përgatiten për të ardhmen e tyre – më shumë se çdo brez para tyre.

Suksesi i fëmijëve në shkollë varet nga parapërgatitja e përgjithshme që u bëhet atyre për të përballuar me sukses procesin mësimor. Kjo parapërgatitje shënon një stad të ri të zhvillimit të përgjithshëm fizik, moral, mendor, estetik dhe të elementeve të edukatës së punës. (Vadahi, 2002).

Sipas Piaget, të mësuarit e fëmijës duhet të udhëhiqet nga principi i burimeve të cilat i ka në disponim fëmija. Gjithashtu, fëmija duhet të lejohet të eksplorojë dhe zbulojë sa më shumë që të jetë e mundur përmes vënies në dispozicion të eksperimenteve të reja. Piaget thekson se nuk mjafton një fëmijë të ketë sistemin nervor të shëndetshëm, për të avancuar në njohjet e tij/saj për botën që e rrethon. Nëse një mësues nuk i jep mundësi fëmijës të përjetojë përvojë të drejtpërdrejtë me objektet, bashkëmoshatarët, të rriturit si dhe mjedisin në të cilin gjendet fëmija, e ka të vështirë të krijoj koncepte apo ide të reja. (Ministria e Arsimit, Kurrikula Bërthamë për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme 0-5 vjeç, 2018).

Hulumtimet tregojnë se ka ndryshime të mëdha zhvillimore në mënyrën se si nxënë fëmijët. Ndërsa fëmijët zhvillohen, ata formojnë mënyra të reja të përfaqësimit të botës dhe gjithashtu ndryshojnë proceset dhe strategjitë që përdorin për të manipuluar këto përfaqësime.

Fëmijët kanë aftësi të ndryshme zhvillimi dhe stile të ndryshme të të nxënës që ndikohen nga koha dhe mënyra e arritjes së pikave të tyre të zhvillimit. Të gjithë fëmijët janë unikë dhe këto dallime duhet të merren parasysh kur kujdesmi për ta. Është e rëndësishme që të nxënës pranimin dhe vlerësimin e dallimeve në aftësitë e të nxënës, me qëllim që të lidhim qëllimet individuale për fëmijët. (Vosnida, 2001).

2.9.2 Veçoritë e arsimit fillor (klasat I-V)

Në këtë nivel, përvojat mësimore në shkollë kontribuojnë për kalimin gradual nga të nxënit përmes lojës në të nxënit më të sistemuar të nxënësve. Puna edukativo-arsimore përqendrohet në përvetësimin e shkrim-leximit themelor, matematikës elementare, njohjes së mjedisit natyror e shoqëror të rrethinës, elementet e edukimit estetik dhe fizik në kontekstin e vendosjes së një baze të shëndoshë për zhvillimin njohës, socio-emocional dhe motorik. Kujdes i veçantë i kushtohet zhvillimit të personalitetit të fëmijës dhe qëndrimit pozitiv të tij për të nxënit që ndihmon zhvillimin e shprehive themelore për “mësim për të nxënë”.

Në klasën e parë, nxënësit u ekspozohen qasjeve sistematike të nxënies. Ata do të njihen me përvojat e mëposhtme të të nxënit:

- Përvetësimin në nivel themelor të komunikimit dhe të të shprehurit në gjuhën amtare
- Komunikimin elementar në gjuhën angleze
- Përvetësimin e elementeve themelore të leximit, shkrimit, dhe llogaritjes me numra
- Hulumtimin dhe njohjen e mjedisit
- Njohjen dhe të kuptuarit e të drejtave, obligimeve dhe përgjegjësisë të tyre në klasë, në shkollë dhe në jetën e përditshme
- Të shprehurit kreativ përmes lojës, simboleve dhe formave elementare të shprehjes artistike
- Krijimin e përvojës së të nxënit të suksesshëm si individ dhe si pjesë e grupit. (Ministria e Arsimit, Kurrikula Bërthamë, 2016).

KAPITULLI 3

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

3.1 Lloji dhe qasja e hulumtimit

Ky studim i përket kategorisë së hulumtimit kuantitativ, me një qasje deskriptive dhe eksploruese, që synon të analizojë perceptimet e prindërve dhe mësimeve të lidhura me moshën optimale për regjistrimin e nxënësve në klasën e parë.

Përdorimi i qasjes kuantitative është konsideruar i përshtatshëm për shkak të natyrës së të dhënave, të cilat janë mbledhur nëpërmjet pyetësorëve të strukturuar me pyetje të mbyllura dhe janë analizuar statistikat.

3.2 Pyetjet e hulumtimit

Duke u bazuar në shqyrtimin e studimeve (literaturës) janë ngritur në vijim pyetjet kërkimore:

1. A ka dallime në perceptimet e prindërve dhe mësimeve mbi ndikimin e moshës së regjistrimit në përgatitjen e fëmijës për shkollë?
2. Cilët janë faktorët përcaktues që ndikojnë në vendimin për regjistrim të nxënësve në klasën të parë?
3. Cilat janë sfidat më të zakonshme me të cilat përballen nxënësit që regjistrohen në moshë më të hershme apo më të vonshme në klasën e parë?

3.3 Hipotezat e hulumtimit

Për një studim të këtij problemi psikologjik dhe pedaogjik, më është dukur e nevojshme t'i parashtrojë këto hipoteza:

H1: Ekziston një dallim në përceptimet e prindërve dhe të mësimeve lidhur me moshën më të përshtatshme për regjistrimin e fëmijëve në klasën e parë, ku prindërit kanë tendencë të favorizojnë regjistrimin më të hershëm për arsye të përfitimeve zhvillimore dhe arsimore.

H2: Zhvillimi kognitiv, emocional dhe social i fëmijës përbën faktorët kryesorë në vendimin për regjistrimin e tij në klasën e parë, më shumë sesa mosha kronologjike apo arsyet praktike të familjes.

H3: Nxënësit që regjistrohen në klasën e parë në moshë më të hershme ose më të vonshme përballen më shpesh me sfida si vështirësi në përqendrim dhe ndjekje të mësimi, në krahasim me bashkëmoshatarët e regjistruar në moshën standarte.

3.4 Popullata dhe mostra e hulumtimit

Popullata e këtij studimi përfshin mësimeve të klasës së parë dhe prindërit e nxënësve të regjistruar në klasën e parë në pesë shkolla fillore të qytetit të Gjilanit:

SHFMU “Selami Hallaçi”, SHFMU “Thimi Mitko”, SHFMU “Musa Zajmi”, SHFMU “Sadullah Brestovci”, SHFMU “Rexhep Elmazi”.

Mostra është përzgjedhur në mënyrë të qëllimshme, me qëllim që të përfshihen individë që kanë njohuri të drejtpërdrejta mbi temën e hulumtimit. Në total, në hulumtim kanë marrë pjesë **27 mësimeve dhe 70 prindër.**

3.5 Instrumenti i mbledhjes së të dhënave

Për të arritur synimet kryesore të vendosura qysh në përzgjedhjen e kësaj teme, vendosa që në realizimin e saj, më saktësisht gjatë hulumtimit të shfrytëzoj metodën e pyetësorit.

Pyetësori ka qenë i strukturuar, i ndarë në dy versione të përshtatura: një për mësimdhënësit dhe një për prindër. Pyetjet kanë qenë të mbyllura, me alternativa të përgjigjeve, si dhe disa pyetje me përgjigje faktike.

Përmbajtja e pyetësorëve është bazuar në literaturë relevante dhe ka synuar të mbulojë aspekte të zhvillimit të fëmijës, perceptimin mbi moshën e duhur për regjistrim, si dhe faktorët që ndikojnë në këtë vendim.

3.6 Procedura e analizës së të dhënave

Të dhënat e mbledhura janë analizuar në mënyrë statistike, duke përdorur teknika të analizës deskriptive si përqindjet. Rezultatet janë paraqitur në formë tabelare dhe grafike përmes programit Excel, me qëllim të ilustrimit qartë shpërndarja e përgjigjeve dhe identifikimi i tendencave të përgjithshme.

3.7 Etika e hulumtimit

Gjatë realizimit të hulumtimit janë bërë respektuar të gjitha parimet etike që lidhen me kërkimin shkencor. Pjesëmarrësit janë informuar paraprakisht mbi qëllimin e hulumtimit dhe janë përfshirë në mënyrë vullnerare.

Anonimiteti dhe konfidencialiteti i të dhënave janë garantuar. Të gjitha informacionet e grumbulluara janë përdorur vetëm për qëllime akademike.

INTERPRETIMI I REZULTATEVE

3.8 Rezultatet e të dhënave në formën tabelare dhe të figurave nga pyetësi i realizuar me mësimdhënësit

Institucioni	Numri i mësimdhënësve pjesëmarrës
SHFMU “Selami Hallaçi”	6
SHFMU “Thimi Mitko”	6
SHFMU “Rexhep Elmazi”	5
SHFMU “Sadulla Brestovci”	5
SHFMU “Musa Zajmi”	5
	Total: 27

Tabela 1. Numri i mësimdhënësve pjesëmarrës në hulumtim për shkolla.

Në tabelën e paraqitur, janë listuar disa institucione arsimore të nivelit fillor dhe të mesëm të ulët (SHFMU) të cilët janë pjesëmarrës në hulumtim, së bashku me një tregues numerik për secilën shkollë të mësimdhënësve pjesëmarrës në hulumtim.

Nga të dhënat e paraqitura në Tabelën , mund të vërehet se pjesëmarrja e mësimdhënësve varion mes 5 dhe 6 për shkollë. Totali i këtyre vlerave arrin në **27**, duke treguar një shpërndarje relativisht të barabartë mes institucioneve, me disa variacione të vogla.

Numri më i lartë i pjesëmarrësve vjen nga shkollat “Selami Hallaçi” dhe “Thimi Mitko”, me nga 6 mësimdhënës secila. Shkollat “Rexhep Elmazi”, “Musa Zajmi” dhe “Sadulla Brestovci” kanë nga 5 pjesëmarrës. Diferenca e pjesëmarrjes midis shkollave është e vogël, gjë që tregon një shpërndarje të ekuilibruar të të dhënave.

1. Sa vite përvojë keni si mësues në klasën e parë?




Figura 1. Analizimi i të dhënave të mbledhura për përvojën e mësuesve të klasës së parë.

Me anën e kësaj pyetje kemi arritur të kuptojmë përvojën profesionale të mësuesve të klasës së parë, duke vlerësuar sa vite punojnë në këtë nivel arsimor.

Të dhënat e grumbulluara janë paraqitur në grafikun cirkular më lartë për një pasqyrim më të qartë të shpërndarjes së përvojës së tyre.

Nga inspektimi i rezultateve vërejmë se numri i mësuesve me më shumë se 10 vite përvojë pune është më 15 apo me një vlerë prej **56%**, duke u pasuar me mësuesit me 6 deri në 10 vite me 5 përgjigje apo **18%**. Ndërsa, me 3-5 vite me 4 përgjigje me **15%** dhe pak dallim nga kjo, me më pak se 3 vite me një numër prej 3 apo **11%**.

Nga këto të dhëna, është e qartë se shumica e mësuesve kanë një eksperiencë të gjatë në mësuesi, më shumë se gjysma e tyre që kanë mbi 10 vite përvojë.

Pra, kemi mësues me përvojë të konsiderueshme, një faktor që mund të ketë ndikim pozitiv në përvetësimin e njohurive nga nxënësit.

2. Sa është numri mesatar i nxënësve në klasën tuaj të parë?

Numri i nxënësve në një klasë është një faktor thelbësor që ndikon në cilësinë e mësimdhënies dhe në rezultatet mësimore të fëmijëve. Kjo pyetje synoi të analizojë madhësinë e klasave të para për të kuptuar shpërndarjen e nxënësve dhe për të vlerësuar nëse klasat janë të mbingarkuara apo ofrojnë një ambient optimal për mësim.




Figura 2. Analizimi i të dhënave të mbledhura për numrin mesatar të nxënësve në klasën e parë.

Bazuar në përgjigjet e mësuesve pjesëmarrës në hulumtim, numri mesatar i nxënësve në klasat e para është shpërndarë në katër kategori kryesore:

- **15-20 nxënës – (18) apo 66%** e mësuesve raportojnë se klasat etyre kanë këtë numër nxënësish. Kjo tregon se shumica e klasave janë relativisht të vogla, duke mundësuar një mësimdhënie më të personalizuar dhe interaktive.
- **21-25 nxënës – (4) apo 15%** e mësuesve kanë raportuar këtë madhësi klase, e cila është ende në një nivel të menaxhueshëm, por mund të kërkojë më shumë vëmendje për secilin nxënës.
- **26-30 nxënës – (4) apo gjithashtu, 15%** e mësuesve kanë klasa me këtë numër nxënësish,
- **Më shumë se 30 nxënës** - vetëm **4%** e mësuesve kanë raporte të klasave me mbi 30 nxënës, duke treguar se rastet e mbingarkesës ekstreme janë të rralla, por ende ekzistojnë.

Numri i nxënësve në një klasë ndikon në mënyrën se si mësuesi mund të menaxhojë orën e mësimi dhe të sigurojë përfshirjen aktive të secilit nxënës.

3. Cila është moshë mesatare e nxënësve që regjistrohen në klasën tuaj të parë?

<i>Moshë</i>	<i>Numri</i>	<i>Përqindja</i>
<i>a) 5 vjeç</i>	0	0%
<i>b) 6 vjeç</i>	25	93%
<i>c) 7 vjeç</i>	2	7%
<i>d) 8 vjeç</i>	0	0%

Tabela 2. Rezultatet e analizës së të dhënave të mbledhura për moshën mesatare të nxënësve që regjistrohen në klasën e parë.

Në këtë tabelë është prezantuar moshë mesatare dhe në anën e djathtë përqindja për secilën moshë. Siç shohim nga tabela moshë mesatare që regjistrohen në klasën e parë është 6 vjeç, ndërsa dy mësimdhënëse kanë konfirmuar se kanë nxënës me moshë mesatare 7 vjeç.

5 vjeç dhe 8 vjeç – nuk është regjistruar asnjë nxënës në këto moshë, duke treguar se regjistrimi i hershëm ose i vonuar jashtë standartit është shumë e rrallë.

Fakti që shumica dërrmuese e nxënësve fillojnë klasën e parë në moshën 6-vjeçare tregon një standardizim të procesit të regjistrimit, duke siguruar që fëmijët të jenë të përgatitur në mënyrë të barabartë për sfidat e mëtejme akademike.

4. A ka shkolla juaj ndonjë kriter shtesë për pranimin e nxënësve në klasën tuaj të parë, përveç moshës?

Procesi i regjistrimit të nxënësve në klasën e parë shpesh përshin jo vetëm kriterin e moshës, por edhe elemente të tjera vlerësuese për të siguruar një përshtatje më të mirë të fëmijëve në sistemin arsimor. Në këtë studim, është analizuar nëse shkolla aplikon kritere shtesë për pranimin e nxënësve në klasën e parë. Nga të dhënat e paraqitura në Tabelën 5, vërehet se shumica dërrmuese e shkollave (25 nga 27 të anketuar) kanë konstatuar se aplikojnë kritere shtesë për pranimin e nxënësve në klasën e parë, përveç kriterit të moshës.




Figura 3. Analizimi i të dhënave të mbledhura për kriterin e pranimit të nxënësve në klasën e parë.

Në figurën më lartë, përqindja e shkollave që zbatojnë kritere shtesë është përfaqësuar me një sektor të madh të verdhë (**93%**), ndërsa ato që nuk zbatojnë kritere shtesë përfaqëson një sektor më të vogël të zi (**7%**).

Duhet theksuar se nga 27 të anketuar në hulumtim dy prej tyre kanë konfirmuar se shkolla e tyre nuk ka kriter shtesë për pranimin e nxënësve në klasë, përveç moshës, konkretisht në shkollën “Thimi Mitko”. Kjo lë hapësirë për të hulumtuar dhe vërtetuar, dhe këtu, lind pyetja se: A vetëm këto dy mësimdhënëse (klasat e tyre) nuk përdorin kritere shtesë, dhe pse? apo përgjigjet e dhëna nga numri tjetër i pjesëmarrësve që kanë pohuar se aplikojnë kritere shtesë është vetëm formalisht, sepse të tjerët kanë aprovuar se aplikojnë kritere tjera, jo vetëm duke u bazuar në moshën kronologjike. Pasi që nga tabela e parë dijmë se, janë 6 pjesëmarrës nga kjo shkollë në hulumtim.

5. Sa të përgatitur janë fëmijët për t'iu përshtatur rregullave dhe rutinës shkollore kur fillojnë klasën e parë?

Përshtatja e fëmijëve me rregullat dhe rutinat e shkollës fillore është një nga sfidat kryesore të fazës së parë të arsimit. Sipas të dhënave të mbledhura, shihet se shumica e fëmijëve janë mesatarisht të përgatitur për t'iu përshtatur rregullave dhe rutinës shkollore në klasën e parë. Kjo kategori përfaqëson pjesën më të madhe të kampionit të anketuar.

Siç vërehet, pjesa më e madhe e grafikut i përket fëmijëve mesatarisht të përgatitur (ngjyra e gjelbër), ndërsa përqindjet më të vogla përfaqësojnë fëmijët të përgatitur (kaltër) dhe pak të përgatitur (e kuqe).




Figura 4. Analizimi i të dhënave të mbledhura për përgatitjen e fëmijëve në përshtatjen e rregullave dhe rutinës shkollore.

Rezultatet tregojnë se shumica e fëmijëve kanë një nivel të kënaqshëm përgatitjeje për shkollën, por ka ende hapësirë për përmirësim. Për këtë arsye, bashkëpunimi mes prindërve dhe mësuesve është thelbësor për të siguruar që çdo fëmijë të ketë një tranzicion të lehtë dhe të suksesshëm në arsimin fillor.

6. Cilat janë karakteristikat më të rëndësishme të gatishmërisë për fëmijët që fillojnë klasën e parë? (Zgjidhni maksimum 3).




Figura 5. Analizimi i të dhënave të mbledhura për aftësitë e gatishmërisë së fëmijëve.

Rezultatet e pyetjes së gjashtë fokusohen në karakteristikat më të rëndësishme që ndikojnë në gatishmërinë e fëmijëve për të filluar klasën e parë.

Nga të dhënat e paraqitura, tri aftësitë kryesore të indentifikuara si më të rëndësishme janë:

1. **Aftësitë emocionale (32%)** – kjo është karakteristika më e rëndësishme sipas pjesëmarrësve. Aftësitë emocionale, si vetëkontrolli, përshtatja me mjedisin e ri dhe ndërveprimi me mësuesit dhe shokët, janë thelbësore për një tranzicion të suksesshëm në shkollë.
2. **Aftësitë sociale (28%)** – aftësia për të bashkëpunuar me të tjerët, për të ndjekur rregullat dhe për të krijuar marrëdhëne të shëndetshme me bashkëmoshatarët është po ashtu një faktor kyç në përshtatjen e fëmijëve me shkollën.
3. **Aftësitë gjuhësore (18.7%)** – komunikimi i qartë dhe aftësia për të shprehur mendimet në mënyrë të kuptueshme ndikojnë drejtpërdrejt në suksesin akademik dhe social të fëmijës në klasën e parë.

Ndërkohë, **aftësitë motorike (12%)** dhe ato **kognitive (9.3%)** kane marrë më pak vëmendje. Kjo tregon se, megjithëse janë të rëndësishme, mësuesit i japin prioritet aftësive emocionale dhe sociale, duke i konsideruar si më të rëndësishme për përshtatjen në shkollë sesa zhvillimi motorik apo kognitiv.

7. Cili faktor mendoni se është më i rëndësishmi për përcaktimin e moshës së regjistrimit në klasën e parë?

Pyetja	Numri	Përqindja
a) Zhvillimi kognitiv, emocional dhe social i fëmijës	16	59%
b) Rregulloret dhe politika arsimore	1	4%
c) Përvoja e fëmijës në arsimin parashkollor	7	26%
d) Vlerësimi i prindërve për gatishmërinë e fëmijës	3	11%

***Tabela 3.** Rezultatet e analizës së të dhënave për faktorët më të rëndësishëm në përcaktimin e moshës së regjistrimit në klasën e parë.*

Të dhënat e paraqitura në Tabelën 3 konfirmojnë **vlefshmërinë e hipotezës së dytë** të këtij hulumtimi, e cila **pohon se zhvillimi kognitiv, emocional dhe social i fëmijës** përbën një ndër **faktorët themelorë në përcaktimin e moshës optimale për regjistrim në klasën e parë.**

Ky faktor është mbështetur nga shumica e pjesëmarrësve në hulumtim me 16 apo (59%), duke e pozicionuar atë si elementin më të rëndësishëm krahasuar me faktorët e tjerë të identifikuar në hulumtim. Kemi edhe një numër të konsiderueshëm që i japin përparësi në arsimin parashkollor (26%) gjë që mendojnë se përmes edukimit parashkollor arrihet edhe zhvillimi individual i fëmijës. Nga rezultatet e kësaj pyetje kemi arritur të kuptojmë rëndësinë e gatishmërisë kognitive, emocionale dhe sociale, duke treguar se mosha kronologjike nuk është gjithmonë treguesi më i mirë i gatishmërisë për shkollë.

8. Cilat janë sfidat më të zakonshme që hasni me nxënësit e rinj në klasën e parë?

Pyetja	Numri	Përqindja
a) Vështirësi në të mësuar	4	14.81%
b) Vështirësi në integrimin social	1	3.70%
c) Vështirësi në përqendrim	21	77.78%
d) Vështirësi në menaxhimin e emocioneve	1	3.70%

***Tabela 4.** Rezultatet e analizës së të dhënave për sfidat me nxënësit e rinj në klasën e parë.*

Përmes kësaj pyetje synuam të identifikojmë sfidat më të zakonshme me të cilat përballen nxënësit e klasës së parë sipas perspektivës së mësuesve të përfshirë në studim.

Tabela 4 rendit sfidat kryesore të evidentuara nga mësimdhënësit. **Hipoteza 3 e parashtruar konfirmohet me anë të kësaj pyetje** nga numri më i madh i përgjigjeve të dhëna nga anketuesit. Sfidat e renditura përfshijnë **Vështirësitë në përqendrim**, e cila është evidentuar si sfida më e zakonshme me **21 përgjigje (77.78)**. Në kontrast sfidat tjera si: vështirësi në të mësuar (14.81%). Vështirësitë në integrimin social dhe në menaxhimin e emocioneve secila me (3.70) janë përmendur më rrallë. Këto rezultate tregojnë qartë se, fokusi në përqendrimin e nxënësve është një nevojë parësore në fazën fillestare të arsimit dhe **vërtetojnë hipotezën e ngritur**.

9. A keni vënë re ndonjë dallim në performancën e nxënësve në varësi të moshës së regjistrimit?




Figura 6. Analizimi i të dhënave të mbledhura për dallimin e performancës së nxënësve në varësi të moshës së regjistrimit.

Kjo pyetje shqyrton nëse mësuesit kanë vërejtur dallime në performancën e nxënësve në varësi të moshës kur ata regjistrohen në klasën e parë.

Grafiku në formë torte ilustron vizualisht rezultatet e mësipërme:

- Pjesa më e madhe e diagramit është e mbuluar nga opsioni **“Po, por jo të dukshme” (e kuqe)**, duke theksuar se shumica e të anketuarve kanë vërejtur ndryshime të vogla në performancën e nxënësve sipas moshës së regjistrimit.
- **Ngjyra e kaltër** përfaqëson grupin që beson se ka **dallime të mëdha**, duke zënë 33% të grafikut.
- **Ngjyra e gjelbër** përfaqëson ata që **nuk kanë vërejtur dallime**, me një përqindje të vogël (11%).
- **Nuk ka ndarje** për opsionin **“Jo, nuk ka dallime”** duke treguar se të gjithë të anketuarit pajtohen se mosha ndikon në njëfarë mënyre në performancën e nxënësve.

10. Në cilat fusha nxënësit që regjistrohen në një moshë më të hershme kanë më shumë vështirësi? (mund të zgjidhni më shumë se një opsion).




Figura 7. Analizimi i të dhënave të mbledhura për vështirësinë e nxënësve në fusha të caktuara.

Grafiku është një histogram që vizualizon të dhënat nga tabela. Ai përbëhet nga shtylla me ngjyra të ndryshme, secila përfaqësuese e një fushe të vështirësive.

Shiriti që përfaqëson **“Përqendrimin dhe ndjekjen e udhëzimeve”** është dukshëm **më i gjatë**, duke reflektuar përqindjen më të madhe të raportimeve. Rrjedhimisht, kjo fushë **shihet si sfida më e madhe për nxënësit** që regjistrohen në moshë më të hershme. Fushat e tjera si, si leximi dhe matematika gjithashtu shfaqen si problematika të konsiderueshme, por në një shkallë më të ulët.

Megjithëse vështirësia në përqendrim paraqitet si element i përbashkët si në Tabelën 4 ashtu edhe në Figurën 7, këto dy raste trajtojnë dimensione të ndryshme të të njëjtit fenomen. **Në Tabelën 4, përqendrimi është trajtuar si një sfidë e përgjithshme** më të cilën përballen nxënësit e klasës së parë, veçanërisht ata që regjistrohen në një moshë më të hershme ose më të vonshme, duke reflektuar kështu vështirësitë e tyre në përshtatjen me ambientin shkollor dhe kërkesat e reja sociale e emocionale.

Ndërsa, në Figurën 7, përqendrimi dhe ndjekja e udhëzimeve përmenden në kontekstin e **fushave konkrete të të nxënësve**, ku kjo vështirësi ndikon drejtpërdrejt në performancën akademike të nxënësve, si në lexim, shkrim apo matematikë.

Ky dallim ndihmon në kuptimin më të thelluar të mënyrës se si përqendrimi luan një rol të dyfishtë – si tregues i maturimit kognitiv dhe emocional, por edhe si aftësi funksionale e domosdoshme për përvetësimin e njohurive në procesin mësimor.

11. Bazuar në përvojën tuaj, cila do të ishte moshë më e përshtatshme për regjistrimin e nxënësve në klasën e parë?

Sipas të dhënave të mbledhura, pjesëmarrësit kanë dhënë opinionet e tyre mbi moshën më të përshtatshme për regjistrimin e fëmijëve në klasën e parë.

Segmenti i grafikut që përfaqëson moshën **7 vjeç** është dominuese me **78%**, duke reflektuar një konsensus të përgjithshëm mbi pjekurinë zhvillimore që nxënësit arrijnë në këtë moshë. Ndërsa, pjesa tjetër që përfaqëson moshën **6 vjeç** është me **22%**.




Figura 8. Analizimi i të dhënave të mbledhura për moshën e përshtatshme për regjistrimin e nxënësve në klasën e parë.

Këto mendime janë rezultat i përvojës së drejtpërdrejtë të mësimeve në klasë dhe vlerësimeve të tyre profesionale, që i japin peshë dhe besueshmëri të lartë të dhënave. **Hipoteza e ngritur në këtë hulumtim, se mësuesit mendojnë se moshë optimale për regjistrim të fëmijëve në klasën e parë është moshë 7 vjeç, është konfirmuar nga këto rezultate,** duke përforcuar idenë se vendimi për regjistrim duhet të merret duke marrë parasysh jo vetëm moshën kronologjike, por edhe maturinë zhvillimore të fëmijës.

12. Cila është mënyra më e mirë për të informuar prindërit mbi gatishmërinë e fëmijëve të tyre për t'i regjistruar në klasën e parë?

Pyetja	Numri	Përqindja
a) Takime të drejtpërdrejta	20	65%
b) Fletushka informuese	4	14%
c) Internet/media sociale	2	8%
d) Lidhje personale me prindërit	1	4%

Tabela 5. Rezultatet e analizës së të dhënave për mënyrën më të mirë për të informuar prindërit mbi gatishmërinë e fëmijëve të tyre për regjistrimin në klasën e parë.

Nga të dhënat e tabelës, shihet qartë se **metoda më e preferuar** për informimin e prindërve është **takimi i drejtpërdrejtë**, i cili është zgjedhur nga **20 pjesëmarrës (65%)**. Kjo tregon se shumica e mësimeve konsiderojnë kontaktin personal si mënyrën më të mirë për të komunikuar informacione të rëndësishme rreth përgatitjes së fëmijëve për shkollë.

Në krahasim, fletushkat informuese kanë një përdorim të zgjedhur nga 4 pjesëmarrës (14%), ndërsa internet/media sociale dhe lidhjet personale me prindërit kanë një ndikim shumë më të vogël, me vetëm 2 (8%) dhe 1 pjesëmarrës (4%), respektivisht.

Të dhënat tregojnë se kontaktet e drejtpërdrejta mes mësimeve dhe prindërve janë mënyra më efektive për të komunikuar rreth gatishmërisë së fëmijëve për shkollë. Kjo mund të jetë për shkak se një komunikim ballë për ballë lejon sqarime të menjëhershme, diskutime interaktive dhe ndërtimin e një marrëdhënie më të fortë besimi.

Rezultatet e të dhënave në formën tabelare dhe të figurave nga pyetësi i realizuar me prindër

1. Gjinia e fëmijës:

Nga të dhënat e mbledhura rezulton se numri i vajzave është më i lartë se ai i djemve. **Vajzat** përbëjnë shumicën e pjesëmarrësve në studim me **42** dhe **djemtë** përbëjnë një numër prej **29**. Shpërndarja tregon një përfaqësim më të lartë të vajzave në grupin e përzgjedhur, ose mund të pasqyrojë prirje demografike specifike të kampionit të analizuar.




Figura 9. Analizimi i të dhënave të mbledhura për gjininë e fëmijës.

Interpretimi i këtyre rezultateve ndihmon në vlerësimin e ndikimit të gjinisë në faktorë të të ndryshëm të studimit dhe në përqasjen e analizës me një qasje të balancuar gjinore.

2. A ka ndjekur fëmija juaj çerdhen ose kopshtin para se të regjistrohet në klasën e parë?

Pyetja	Numri	Përqindja
a) Po, ka ndjekur çerdhen	31	41.33%
b) Po, ka ndjekur kopshtin	37	49.33%
c) Jo, ka filluar direkt në klasën e parë	7	9.33%

Tabela 6. Rezultatet e analizës së të dhënave të mbledhura për ndjekjen e çerdhes ose kopshtit nga fëmija para regjistrimit në klasën e parë.

Një nga aspektet kyçe të këtij hulumtimi ishte të kuptuarit e përvojës parashkollore të fëmijëve përpara regjistrimit në klasën e parë. Për këtë qëllim, prindërit u pyetën nëse fëmija i tyre kishte ndjekur çerdhen, kopshtin ose kishte filluar direkt në klasën e parë.

Të dhënat e mbledhura janë paraqitur në tabelën e mësipërme.

Kjo tabelë paraqet rezultatet e hulumtimit të realizuar me prindërit, lidhur me përvojën parashkollore të fëmijëve të tyre përpara regjistrimit në klasën e parë. Të dhënat janë të strukturuar në tri kategori kryesore: ata **që kanë ndjekur çerdhen 31 fëmijë**, ata **që kanë ndjekur kopshtin 37 fëmijë** dhe **që kanë filluar direkt në klasën e parë – 7 fëmijë**.

Këto rezultate tregojnë rëndësinë e institucioneve parashkollore në përgatitjen e fëmijëve për arsimin fillor. Shumica e prindërve zgjedhin që fëmijët e tyre të ndjekin çerdhen ose kopshtin, gjë që mund të ndikojë pozitivisht në zhvillimin e tyre akademik dhe social.

3. Në çfarë moshe keni regjistruar fëmijën tuaj në klasën e parë?

Një aspekt i rëndësishëm i këtij hulumtimi ishte të kuptuarit e moshës në të cilën prindërit i regjistrojnë fëmijët e tyre në klasën e parë.




Figura 10. Analizimi i të dhënave të mbledhura për moshën e regjistrimit.

Grafiku rrethor i mësipërm vizualizon shpërndarjen e këtyre të dhënave, duke treguar **dominimin e regjistrimit në moshën 6-vjeçare** me një ngjyrë dominuese, ndërsa dy grupet e tjera kanë përfaqësime më të vogla. Ngjyra të ndryshme ndihmojnë në dallimin e secilës kategori dhe në kuptimin më të lehtë të rezultateve.

Këto rezultate janë në përputhje me politikat arsimore të shumicës së vendeve, ku mosha 6- vjeçare është standarte për fillimin e shkollimit fillor. Nga ana tjetër, **16%** e prindërve **zgjedhin të shtyjnë regjistrimin deri në moshën 7 vjeçare**, gjë që mund të jetë e lidhur me zhvillimin individual të fëmijës ose faktorë të tjerë socio-ekonomike.

Këto të dhëna mund të shërbejnë si bazë për analiza të mëtejshme mbi ndikimin e moshës së regjistrimit në performancën akademike të fëmijëve dhe përshtatshmërinë e politikave ekzistuese arsimore.

4. Cilat ishin arsyet kryesore për të zgjedhur këtë moshë për regjistrim?

Për të kuptuar faktorët që ndikojnë në vendimin e prindërve për regjistrimin e fëmijëve në klasën e parë, u analizuan përgjigjet e tyre mbi arsyet kryesore që kanë ndikuar në këtë zgjedhje. Të dhënat e mbledhura janë paraqitur në tabelën e mësipërme dhe grafikun e dhënë mëposhtë. Rezultatet tregojnë se **faktori kryesor që ndikon në regjistrimin e fëmijëve në klasën e parë është moshë ligjore e pranimi në shkollë**, e cila përbën 39 të përgjigjeve të të anketuarve. Zhvillimi kognitiv dhe emocional i fëmijës ishte faktori i dytë më i rëndësishëm (27), ndërsa rekomandimet e shkollës ose mësuesve u përmenden nga 15 prindër. Dëshira për të filluar sa më shpejt edukimin formal u përzgjedh nga një numër më i vogël (6), ndërsa asnjë prind nuk e konsideroi përputhjen me orarin familjar dhe punën e prindërve si faktor vendimtar.




Figura 11. Analizimi i të dhënave të mbledhura për arsyet e përzgjedhjes së moshës së regjistrimit.

Në këtë rast, **hipoteza e ngritur se zhvillimi kognitiv, emocional dhe social janë faktorë vendimtar për regjistrimin e fëmijëve në klasën e parë, nuk del të jetë e mbështetur njësoj si nga mësimdhënësit**. Ndryshe nga përvoja e mësimdhënëseve, të cilët vërejnë ndryshime të dukshme sipas nivelit të pjekurisë, fokusi i prindërve mbetet më shumë në aspektin formal dhe juridic të moshës, sesa në gatishmërinë e zhvilluar të fëmijës për të filluar shkollën. Ky dallim tregon se prindërit dhe mësimdhënësit i qasen ndryshe çështjes së regjistrimit: prindërit mbështeten në rregulla të përgjithshme, ndërsa mësimdhënësit në vlerësime profesionale dhe përvojës së tyre.

5. A keni diskutuar me psikologun e shkollës, mësuesit apo edhe me ndonjë prind tjetër për moshën e duhur të regjistrimit të fëmijëve? Nëse po, me kë?

Pyetja	Numri	Përqindja
a) Po	50	71%
b) Jo	20	29%

***Tabela 7.** Rezultatet e analizës së të dhënave të mbledhura për diskutimin e prindërve me psikologun e shkollës, mësuesit apo edhe prindërit e tjerë.*

Nga tabela mund të vërejmë se: **71%** e të anketuarve (**50 persona**) kanë diskutuar për këtë çështje me profesionistë apo prindër të tjerë.

Nga përgjigjet e prindërve, u identifikuan disa grupe kryesore me të cilët ata kanë diskutuar për këtë vendim:

- **Mësuesit dhe stafi i shkollës** – prindërit shpesh konsultohen me profesionistë të arsimit numër i madh i prindërve janë konsultuar me psikologun/en e shkollës për të vlerësuar pjekurinë emocionale dhe kognitive të fëmijës, pastaj pedagogun, drejtorin, mësuesë, edukatoret ku fëmijët e tyre kanë vijuar parashkollorin, madje prindërit kanë cekur se edukatoret i kanë ofruar këshilla bazë për zhvillimin emocional dhe social.
- **Antarët e familjes** – prindërit diskutojnë me gjyshe të cilat kanë qenë edukatore apo mësimdhënëse, bashkëshortër të cilët po ashtu janë mësimdhënës, si dhe me familjarë të tjerë që kanë përvojë në fushën e arsimit.
- **Prindër të tjerë** – shpesh prindërit kanë theksuar se kërkojnë mendime nga ata që kanë kaluar të njëjtën mendime nga ata që kanë kaluar të njëjtën përvojë për të kuptuar më mirë sfidat dhe përfitimet e regjistrimit në një moshë të caktuar.

Disa prindër që kanë qenë pjesëmarrës në hulumtim kanë konstatuar se janë bazuar edhe nga përvojat e tyre personale me fëmijën e parë që kanë regjistruar në klasën e parë.

6. Si ka reaguar fëmija juaj emocionalisht gjatë ditëve të para të shkollës?

Pyetja	Numri	Përqindja
a) Ishte i/e lumtur	56	80%
b) Ishte paksa i/e shqetësuar	8	12%
c) Ishte i/e stresuar dhe kishte vështirësi të mëdha në përshtatje	5	7%
d) Vazhdoi të ndjejë ankth për një periudhë të gjatë	1	1%

***Tabela 8.** Rezultatet e analizës së të dhënave të mbledhura për emocionet e fëmijëve në ditët e para të shkollës.*

Në këtë tabelë mund të vërejmë se një numër i madh i fëmijëve kanë qenë të lumtur në ditët e para të shkollës 56 prej tyre e kanë përjetuar fillimin e shkollës si një përvojë pozitive. Megjithatë, një pjesë e konsiderueshme e fëmijëve 8 prej tyre e përjetuan në një nivel të caktuar shqetësimi, madje 5 prej tyre kanë ndjerë edhe stres, ndërsa një numër shumë i vogël 1 prej tyre përjetoi ankth për një periudhë të gjatë.

Më poshtë janë të paraqitura përqindjet përkatëse:

- **80% e nxënësve** janë ndjerë të lumtur.
- **12% e nxënësve** kanë qenë të stresuar dhe kanë pasur vështirësi të mëdha në përshtatje.
- **7% e nxënësve** kanë qenë paksa të shqetësuar.
- **1% e nxënësve** kanë vazhduar të ndiejnë ankth për një periudhë të gjatë.

7. A mendoni se mbështetja e mësuesve ndihmoi fëmijën tuaj të përshtatej emocionalisht në klasën e parë?




Figura 12. Analizimi i të dhënave të mbledhura për mbështetjen e mësuesve në ndihmën për t'u përshtatur fëmijët emocionalisht në klasën e parë.

Në këtë figurë shohim se kemi arritur rezultatet maksimale lidhur me mbështetjen e mësuesve, duke i ndihmuar fëmijët për të kaluar më lehtë sfidat që ata janë ballafaquar.

Rrethi i grafikut është plotësisht i mbushur me ngjyrën për opsionin **“Shumë”**, duke treguar se të gjithë fëmijët janë vlerësuar më këtë nivel.

Kjo paraqitje grafike konfirmon në mënyrë të qartë dhe të drejtëpërdrejtë se asnjë fëmijë nuk është raportuar të ketë pasur vështirësi emocionale apo sociale në përshtatjen me klasën e parë. Këto rezultate janë tregues pozitiv për sistemin edukativ dhe metodat e përdorura në ndihmën ndaj fëmijëve gjatë këtij kalimi të rëndësishëm akademik.

Këto të dhëna tregojnë një nivel të lartë integrimi të fëmijëve në ambientin shkollor dhe sugjerojnë se faktorët mbështetës si mësimdhënia, qasja pedagogjike dhe përgatitja paraprake kanë luajtur një rol kyç në këtë përshtatje të suksesshme.

8. Cilat ishin sfidat më të mëdha që përjetoi fëmija juaj në fillim të klasës së parë? (mund të zgjidhni më shumë se një opsion).

Me anë të kësaj pyetje qëllimi ishte të kuptohet se cilat janë vështirësitë kryesore me të cilat përballen fëmijët dhe sa të përhapura janë ato në mesin e tyre. Në këtë pyetje prindërit kanë pasur mundësinë të zgjedhin më shumë se një opsion lidhur me sfidat e fëmijët të tyre në klasën e parë.




Figura 13. Analizimi i të dhënave për sfidat e përjetura nga fëmijët në fillimin e klasës së parë.

- Sipas të dhënave, **38%** e prindërve raportojnë se fëmijët e tyre **nuk kanë pasur sfida të mëdha** në fillim të klasës së parë, duke treguar se një pjesë e madhe e fëmijëve përshtaten pa vështirësi të mëdha. Në krahasim me mësimdhënësit, të cilët shpesh i lidhin sfidat me maturinë zhvillimore dhe përgatitjen për shkollë, prindërit kanë një qasje më personale dhe subjektive. Si rrjedhojë, **hipoteza se moshë e fëmijës ndikon drejtpërdrejt në përgatitjen dhe suksesin e fëmijëve, në këtë rast, nuk gjen mbështetje të qartë, sepse prindërit nuk e lidhin drejtpërdrejt moshën me sfidat, por me përjetimet emocionale të fëmijës.** Kjo tregon se prindërit shpesh fokusohen te përvoja individuale e fëmijës dhe jo në analizën e pjekurisë psikologjike apo zhvillimore që është thelbësore për vlerësimin e gatishmërisë shkollore.

- **Përqendrimi dhe ndjekja e mësimit (23%)** është sfida më e përhapur, duke treguar se shumë fëmijë kanë vështirësi në ndjekjen e rutinës shkollore. Rezultatet tregojnë se shumica e fëmijëve përshtaten mirë me shkollën, por ka një grup që hasin sfida kryesisht në përqendrim dhe ndjekjen e mësimit. Kjo mund të lidhet me ndryshimin nga një mjedis më i lirë siç është kopshti, një një strukturë më të organizuar siç është shkolla.
- **Mësimi i shkronjave dhe numrave (17%)** është gjithashtu një sfidë e rëndësishme, duke reflektuar vështirësitë fillestare të nxënësit.
- **Pranimi i rregullave dhe procedurave të klasës (12%) dhe përshtatja sociale (10%)** janë sfida më të vogla, por ende të rëndësishme për një grup të konsiderueshëm fëmijësh.

9. A mendoni se mosha e regjistrimit ndikon në suksesin e fëmijës tuaj?

Pyetja	Numri	Përqindja
a) Po, fëmijët më të vegjël mund të kenë më shumë vështirësi në mësim	25	36%
b) Po, fëmijët më të mëdhenj janë më të përgatitur për mësim	27	39%
c) Jo, mosha nuk ka ndikim të madh në suksesin mësimor	18	26%

***Tabela 9.** Rezultatet e analizës së të dhënave të mbledhura për ndikimin e moshës së regjistrimit në suksesin e fëmijës.*

Të dhënat e mbledhura për pyetjen se nëse prindërit besojnë se mosha e regjistrimit ndikon në suksesin shkollor të fëmijëve të tyre, përgjigjet e dhëna nga ana e tyre janë paraqitur në tabelën e mësipërme për një analizë më të qartë.

Të dhënat tregojnë një ndarje të qartë të mendimeve midis prindërve, por mes atyre që besojnë se fëmijët më të vegjël mund të kenë më shumë vështirësi në mësim dhe fëmijët janë më të mëdhenj janë më të përgatitur për mësim ka vetëm pak dallim në përqindje prej 3%.

39% prej tyre besojnë se fëmijët më të mëdhenj janë më të suksesshëm në suksesin mësimor.

10. A keni ndihmuar fëmijën tuaj në përgatitjen për klasën e parë? Nëse po, cilat aktivitete keni përdorur? (mund të zgjidhni më shumë se një opsion).

Në këtë grafik kam paraqitur aktivitetet të cilët prindërit i kanë përdorur në përgatitjen për gatishmërinë e fëmijëve të tyre për të filluar klasën e parë. Një numër i madh i respondentëve përmes përgjigjeve të tyre kanë potencuar se kanë përdorur aktivitete për zhvillimin e shkathtësive motorike siç janë shkrimi, vizatimi dhe lojëra të ndryshme. Një pjesë e prindërve janë përkushtuar në leximin dhe tregim përrallash, ndërsa vetëm një numër më i vogël i tyre rëndësi më të madhe i kanë kushtuar përgatitjes emocionale, duke bërë kështu biseda mbi shkollën, madje **44 prej tyre kanë bërë vizita paraprakisht në objektin e shkollës**. Duke e ditur se matematika është një nga lëndët bazë në sistemin arsimor, **24 prindër janë përgjigjur se kanë bërë përgatitje në këtë aspekt**. Vetëm **3 prindër** nga gjithë prindërit që kanë marrë pjesë në hulumtim kanë konstatuar se **nuk kanë bërë asnjërën nga opsionet e cekura, ose edhe ndonjë tjetër jashtë këtyre**.




Figura 14. Analizimi i të dhënave të mbledhura për përgatitjen e fëmijëve për klasën e parë dhe aktivitetet e përdorura nga ana e prindërve.

Si rrjedhojë e analizimit të të dhënave lidhur me këtë pyetje, kemi një rezultat që në bazë të shiritave ofrojmë një përqindje përkatëse për opsionet e lartëpërmendura.

Siç shihet edhe nga figura e dhënë përqindja më e lartë korresponon me **30%** të prindërve të cilët kanë bërë aktivitete për **zhvillimin e shkathtësive motorike**, këtu mund të hyj edhe mbajtja e lapsit, ushtrime për të shkruar, vizatuar apo edhe përmes lojërave.

11. A mendoni se programi mësimor i klasës së parë është i përshtatshëm për moshën e fëmijës tuaj?

Pyetja	Numri	Përqindja
a) Po	57	81%
b) Jo	13	19%

***Tabela 10.** Rezultatet e analizës së të dhënave të mbledhura për përshtatshmërinë e programit mësimor në klasën e parë.*

Në këtë seksion paraqiten rezultatet e pyetjes me prindërit nëse programi mësimor i klasës së parë është i përshtatshëm për moshën e fëmijëve të tyre.

Nga tabela e mësipërme mund të shohim dhe kuptojmë se kemi numër të lartë të prindërve që mendojnë se programi mësimor është i përshtatshëm për moshën e fëmijës së tyre (**57**) pra, ata nuk shohin ndonjë papërshtatshmëri në atë që mësojnë fëmijët e tyre, kurse një numër më i vogël (**13**), theksojnë se nuk e cilësojnë si të përshtatshëm programin.

Të dhënat tregojnë se një ndarje të qartë të mendimeve të prindërve. Shumica e tyre (**81%**) besojnë se programi mësimor është i përshtatshëm me moshën e fëmijës. Nga ana tjetër, (**19%**) e prindërve mendojnë se nuk përkon me moshën e fëmijës.

12. Sipas jush, cila është moshë më e përshtatshme për të filluar klasën e parë?

Me anë të kësaj pyetje kemi arritur të shohim perceptimet e prindërve dhe mendimet e prindërve sa i përket moshës së përshtatshme për fillimin e klasës së parë të fëmijëve. Përmes kësaj pyetje ne kemi arritur edhe të **vërtetojmë hipotezën e parashtruar sa i përket qëndrimeve të prindërve dhe mësimdhënësve për çështjen e moshës.**

Nga të dhënat e paraqitura në figurë, vërehet se **shumica e prindërve e konsiderojnë moshën 6-vjeçare si më të përshtatshme për regjistrimin e fëmijës në klasën e parë.** Kjo zgjedhje lidhet kryesisht me respektimin e moshës llogjore të përcaktuar nga politikat arsimore në Kosovë dhe më pak me analizën individuale të zhvillimit të fëmijës.

Përmes grafikut shohim se në krahasim nga pyetësi i realizuar me mësimdhënës të klasë së parë, këtu kemi krejtësisht qëndrime të ndryshme. 46 prindër apo **67%** e tyre, moshë të përshtatshme duke u bazuar në të gjitha aspektet zhvillimore dhe përgatitjet e tjera e konsiderojnë moshën **6 vjeçare**, kemi edhe një numër prej 23 apo **33%** të prindërve të cilët besojnë se moshë optimale është **7 vjeç.**




Figura 15. Analizimi i të dhënave të mbledhura mbi opinionin e prindërve për moshën e përshtatshme të regjistrimit të fëmijëve në klasën e parë

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Bazuar në të dhënat e mbledhura dhe literaturën e shqyrtuar, arrijmë në përfundimin se mosha optimale për regjistrimin e nxënësve në klasën e parë nuk mund të përcaktohet në mënyrë të njëtrajtshme për të gjithë fëmijët. Zhvillimi individual – si ai kognitiv, emocional, social dhe fizik ndryshon nga një fëmijë te tjetri, pastaj vendimmarrja duhet të jetë fleksibile dhe e bazuar në vlerësime profesionale.

Studimi tregoi se, edhe pse mosha 6-vjeçare është përcaktuar si standart ligjor për regjistrim në Kosovë, një numër i konsiderueshëm mësimitdhënësish dhe prindërish mbështesin idenë që fëmijët duhet të fillojnë shkollën vetëm kur janë realisht të gatshëm, pavarësisht moshës kronologjike. Gatishmëria për shkollë përfshin më shumë se vetëm moshën – ajo përfshin zhvillimin emocional, përqendrimin, ndërveprimin social, vetëkontrollin dhe motivimin për të mësuar. Në bazë të analizës së pyetjeve kërkimore dhe testimit të tri hipotezave të parashtuara u vërtetua se:

- Prindërit dhe mësimitdhënësit kanë qëndrime të ndryshme, por që ndihmojnë në plotësimin e njëri-tjetrit. Prindërit shpesh mbështesin regjistrimin më të hershëm duke u bazuar në përvojën individuale të fëmijës, ndërsa mësimitdhënësit theksojnë rëndësinë e pjekurisë emocionale dhe zhvillimit social.
- Faktorët vendimmarrës për regjistrim përfshijnë opinionin e familjes, rekomandimet e mësuesve të çerdhes/kopshtit, por më e rëndësishmja zhvillimin individual të fëmijës.
- Dallimet në suksesin e nxënësve në varësi të moshës së regjistrimit janë të dukshme: fëmijët që regjistrohen shumë shumë herët shpesh përballen me vështirësi në përshtatje, përqendrim dhe ndërveprim social, ndërsa ata që regjistrohen më vonë shpesh tregojnë vetëbesim dhe gatishmëri më të lartë.

Nga rezultate të përgjithshme mund të nxirren këto përfundime kryesore:

1. **Mosha kronologjike nuk duhet të jetë kriteri i vetëm** në vendimin për regjistrim në klasën e parë. Duhet të merrën parasysh edhe aspektet zhvillimore – si pjekuria emocionale, zhvillimi kognitiv, përvoja sociale dhe gatishmëria e përgjithshme për mësim.
2. **Pjesëmarrja në edukimin parashkollor** paraqitet si një faktor kyç që ndikon pozitivisht në tranzicionin e fëmijës drejt shkollimit formal.
3. **Përfshirja e prindërve dhe e profesionistëve** në vendimmarrje rezulton e domosdoshme për të siguruar një fillim të suksesshëm të arsimit fillor.
4. **Fëmijët janë të ndryshëm në ritmin e tyre të zhvillimit**, prandaj regjistrimi duhet të jetë fleksibil dhe i bazuar në nevojat individuale, jo vetëm në kufijtë ligjore të moshës.

Duke u bazuar në këto përfundime, propozojmë këto rekomandime:

- **Institucionet arsimore** të zgjerojnë rolin e vlerësimit zhvillimor përpara regjistrimit, përmes ekipeve multidisiplinare që përfshijnë psikologun shkollor, mësuesin e klasës së parë dhe pedagogun.
- **Prindërit të vetëdijësohen** që të mos e shohin regjistrimin si një çështje administrative, por si një vendim i rëndësishëm për të ardhmen e fëmijës që duhet marrë në bazë të këshillës profesionale.
- **Shkollat dhe DKA-të** të organizojnë takime informuese për prindërit çdo vit para regjistrimeve, me qëllim edukimin mbi kriteret e gatishmërisë shkollore dhe ndikimin e moshës në zhvillim.
- **Të mbështeten trajnimet** për mësime dhënësit e klasës së parë që të identifikojnë më mirë nevojat e fëmijëve në vitin e parë të shkollimit.

3.9 REKOMANDIMET NGA MËSIMDHËNËSIT

Nga pyetësorët me mësimdhënësit, disa nga rekomandimet e tyre përfshijnë:

- ✓ *Fëmijët të vijojnë entet parashkollore, të njihen (jo t'i mësojnë) me shkronjat dhe numrat.*
- ✓ *Unë do të sugjeroja që regjistrimi i nxënësve në klasën e parë të jetë në moshën 7 vjeçare, sepse fëmijët ende po e kanë mendjen te loja dhe po ju mungon përqëndrimi.*
- ✓ *Që të krijojë një ambient të ngrohtë dhe të sigurtë, të përdorin lojëra bashkëpunuese, të cilat u ndihmojnë atyre në shprehjen e emocioneve dhe të inkurajojnë ndërveprimin me shokët/shoqet përmes aktiviteteve në grupe dhe çifte.*
- ✓ *Inkurajoni fëmijën të shpreh ndjenjat e tij dhe të afroji mbështetje kur është e nevojshme, përfshini në aktivitete të ndryshme, lavdëroni përpjekjet dhe arritjet e fëmijës për ta ndërtuar vetëbesimin dhe motivimin e tij.*
- ✓ *Përshtatja e fëmijëve në shkollë është një proces i rëndësishëm që kërkon mbështetje të vazhdueshme nga prindërit dhe mësuesit.*
- ✓ *Që fëmija të përshtatet më lehtë emocionalisht dhe socialisht është moshë 7 vjeç edhe pse varet nga zhvillimi individual i fëmijës.*
- ✓ *Bashkëveprimi prind-mësues. Tu flasim fëmijëve, si të bashkëveprojnë me moshatarët e tyre.*
- ✓ *Duhet dërguar në institucione edukative dhe sociale qysh nga moshë e hershme ku bëhet socializimi dhe përshtatja emocionale, e dyta prindërit duhet të punojnë rreth përgatitjes emocionale dhe sociale para se fëmija të shkojë në çerdhe (kopsht), Entin parashkollor:*
 - *Përgatitja emocionale – duhet që nxënësit ta ndjejnë veten të sigurt, t'i ndëgjojmë shqetësimet e tyre.*
 - *Përgatitja sociale – duhet t'i mësojnë që bisedën ta fillojnë me shkoë ose shoqe.*
 - *Duhet të luajnë me rregulla, kjo ju ndihmon në zhvillimin e ndarjes dhe pritjes së radhës.*
 - *Duhet t'ua rrisim vetëbesimin etj.*
- ✓ *Fëmijët duhet të jenë në moshën 7 – vjeçare ose mbi këtë moshë, të jenë pak a shumë të përgatitur nga prindërit dhe edukatorët.*

- ✓ *Krijimi i një ambienti të ngrohtë dhe të sigurt. Lojëra dhe aktivitete sociale, rutina të qarta dhe të qëndrueshme, vlerësimi dhe inkurajimi, përfshirja e prindërve, komunikimi i hapur dhe mbështetës.*
- ✓ *Të jetë shumë i afërt dhe i dashur për nxënësit. Ti përkdhelë dhe t'ju ndihmoj në vështirësitë e të nxënësve. Duhet që mësuesi t'iu përshtatet çdo moshe të nxënësve 1 deri 5.*
- ✓ *Do t'u sugjeroja se shkolla është një vend për të zbuluar vetën, për të bërë miq, dhe për t'u argëtuar duke mësuar.*

3.10 REKOMANDIMET NGA PRINDËRIT

Nga ana tjetër, prindërit kanë rekomanduar:

- ✓ *Që të krijojnë rutina të qëndrueshme, të lexojnë dhe të bisedojnë rregullisht me fëmijët e tyre, si dhe t'i ndihmojnë të zhvillojnë pavarësinë dhe aftësitë sociale përmes lojës dhe detyrave të lehta argëtuese që i bëni së bashku!*
- ✓ *Regjistrimin e fëmijës në parashkollorë, të sigurojnë ndonjë libër me aktivitete e ushtrime në gjuhë shqipe, matematikë etj. Ta ndalojnë rreptësisht përdorimin e telefonit e lojërave të shumta kompjuterike!*
- ✓ *Fillimisht fëmijët duhet të krijojnë mendime të mira dhe të dashura për shkollën e sidomos për mësuesen, ndërsa sa i përket çështjes akademike të njihen me shkronjat, numrat dhe figurat e thjeshta, të tjerat i mësojnë me kohë!*
- ✓ *Unë sugjeroj më shumë aktivitete motorike dhe lojëra logjike që tërthorazi zhvillojnë të menduarit dhe arritjen deri të zgjidhja.*
- ✓ *Të përgatisin fëmijët për perceptimin e shkronjave, duke i ushtruar ata. Të fillojnë të mësojnë fëmijët që koncentrimi në klasë është primare në aspektin e të nxënësve mësues.*
- ✓ *Përmirësimi i aftësive sociale. Përmirësimi i aftësive të komunikimit dhe dëgjimit aktiv, nxitja e kuriozitetit dhe dëshirës për mësimin, zhvillimi i pavarësisë tek fëmija.*

- ✓ *Unë mendoj se çdo prind paraprakisht duhet ta përgatis emocionalisht fëmijën, duhet t'i flas fëmijës për shkollën dhe të mirat që i sjellë ajo, pastaj edhe fillimi parashkollor është i rëndësishëm për përgatitjen e një fillimi të suksesshëm në shkollë.*
- ✓ *Ndoshta të kisha qenë mësuese, kisha pas më shumë me shkru për këtë. Por më shumë kisha sugjeru që shkolla të ketë planprogram më të avancuar që fëmijët të punojnë më shumë në shkollë që të lirohem pak ne si prindër, nga detyrat shkollore të fëmijëve. E të kemi më shumë kohë të mirremi me fëmijët me gjëra tjera, si: p.sh., me edukimin e tyre, mësimet rreth përgjegjësi, kuptimit të aftësive të tyre etj.*
- ✓ *Ndjekja e parashkollorit është esenciale. Flisni me fëmijët tuaj. Ngjallni kuriozitet për të mësuar gjëra të reja. Fëmijët nuk janë njësoj, mos bëni shumë krahasime me fëmijët e tjerë. Flisni paraprakisht me edukatoren, prindërit e tjerë dhe psikologun e shkollë.*
- ✓ *Bëni sa më tepër lojëra dhe aktivitete të ndryshme me fëmijë. Kaloni kohë me ta. Mos i dërgoni fëmijët në klasë të parë para moshës 7 vjeç për hatër të ndonjë mësuesi apo diçka tjetër, sepse 1 vjet më shumë në këtë moshë, don të thotë deri 100 % pjekuri më tepër se në moshën para 1 viti. Dhe mos i mësoni shkrim, lexim, etj., që fëmijët mos ta humbasin interesimin në klasën e parë.*
- ✓ *Më e rëndësishmja është që fëmija të jetë i gatshëm emocionalisht dhe akademikisht për shkollën, një fëmijë që është i motivuar do të ketë sukses pavarësisht nëse ka filluar pak më herët apo më vonë. Përgatitja e fëmijës për shkollë është një proces i vazhdueshëm.*

Disa nga sugjerimet nga ana ime për prindërit e tjerë janë: nxitjen e pavarësisë tek fëmiju (mësojeni fëmijun të vetëkujdeset si shkuarja në tualet dhe larja e duarve pa ndihmë), krijimi i një rutine të qëndrueshme (filloni me një orar të rregullt të gjumit, praktikoni të qëndruarit ulur dhe ndjekjen e udhëzimeve), përgatitja për aftësitë bazë akademike (gjithmonë duke praktikuar numërimin dhe njohjen e shkronjave në mënyrë sa ma argëtuese, bëni aktivitete me ngjyrosje dhe vizatim për të përmirësuar aftësitë motorike, përmirësimi i aftësive gjuhësore, komunikimit (lexoni libra çdo herë për të zhvilluar të kuptuarit, praktikoni biseda të thjeshta dhe bëni pyetje për të nxitur të menduarit), dhe shumë e rëndësishme Mos e krahasoni me fëmijët e tjerë, çdo fëmijë zhvillohet me ritmin e tij, pa merak.

- ✓ *Gjithmonë duhet të kemi parasysh zhvillimin e fëmijës si dhe cilësitë që ai posedon, e nga kjo varet edhe përgatitja e fëmijës para se të hyjë në shkollë. Për mendimin tim nuk duhet t'i ngarkojmë fëmijët më herët me shkronja si dhe gjëra që janë të planifikuara për t'u bërë në klasë të parë.*
- ✓ *1. Krijoni rutinë: përcaktimi i orarit të gjumit, ushqimit, aktiviteteve.*
- 2. flisni për shkollën: biseda rreth shkollës, mësuesve, shoqe/shokë etj.*
- 3. vizitoni shkollën: mësoni sado pak me ambientin e shkollës para se të fillon.*
- 4. mbështetja emocionale: që fëmija të ndihet i sigurt dhe i dashur.*
- 5. përgatitja e materialeve: ti zgjedhin së bashku librat dhe çantat.*
- E shumë të tjera që mund ta ndihmojë fëmijën.*
- ✓ *Me fëmijët duhet të punohet shumë si para fillimit të shkollës, ashtu edhe pas. Program mësimor është shumë i ngjeshur dhe kërkon shumë përkushtim që të kapet si duhet nga fëmijët.*
- ✓ *Të diskutohet me profesionistë dhe të vlerësohet se a ëshët fëmija i gatshëm për shkollë. Të përgatitet fëmija në aspektin emocional.*
- ✓ *Të flasin më shumë rreth ambientit, njerëz të rinj që do të takojnë, të flasin më tepër rreth gjuhës formale që përdoret gjatë mëimit.*

Ky hulumtim sjell një kontribut të vlefshëm në fushën e edukimit, duke ndihmuar prindërit, mësuesit dhe politikbërësit të marrin vendime më të informuara mbi regjistrimin e fëmijëve në klasën e parë. Hulumtime të mëtejshme mund të analizojnë ndikimin afatgjatë të moshës së regjistrimit në suksesin akademik dhe zhvillimin social të nxënësve në vitet e mëvonshme të shkollimit. Një politikë më fleksibile dhe e bazuar në vlerësime profesionale mund të ndihmojë që çdo fëmijë të fillojë arsimin fillor në momentin më të përshtatshëm për të.

Bibliografia

- Beci, B. (2006). "Valle shkronjash dhe Tinguish". (p. 4).
- Bekteshi, S. B. (2009). *"Mbingarkimi i nxënësve me mësim në shkollë"*. Prishtinë.
- Bertram, T., & Pascal, C. (2016). *Early childhood policies and systems in eight countries: . Findings from IEA's early childhood education study*. Springer .
- Bjorklund, D. F., & Causey, K. B. (2018). Children's thinking: Cognitive development and individual differences (6th ed.). . *Children's thinking: Cognitive development and individual differences (6th ed.)*. .
- Brada, R. (1984). *"Zgjidhja Pedagogjike e situatave konflikte te nxënësit e moshës së re shkollore"* .
- Burke, W. K., Kiranxhiska, S., & Llazzarevski, G. T. (n.d). *Krijimi i mjedisit për të nxënit për shekullin XXI*. Shkup.
- Datar, A. (2006). The impact of changes in kindergarten entrance age policies on children's academic achievement and the attainment gap. *Journal of Human Resources*, 41 (1), 1-30. Marrë nga: <https://doi.org/10.1016/j.econedurev.2004.11.002>
- Dërvodeli, J. (2010). *"Dallimet në suksesin e nxënësve të shkollës fillore të regjistruar para kohe, me kohë dhe pas kohe"*. Prishtinë.
- Dërvodeli, J. (n.d). "Zhvillimi historik i institucioneve parashkollore". (shih fq. 110-115).
- Diamond, A. (2013). Annual Review of Psychology, 64 (1). *Executive functions* , 135-168. Marrë nga: <https://doi.org/10.1146/annurev-psych-113011-143750>.
- Duncan, G. J., Dowsett, C. J., Claessens, A., Magnuson, K., Huston, A. C., Klebanov, P., & Japel, C. (2007). School readiness and later achievement. *Development Psychology* 43 (6). 1428-1446.
- Edelmann, D., Beeler, K., Krienbühl, Claudia, S., & Fabienne, B. (2019). DER EINTRITT IN DIE SCHULE - EINE CHANCE FÜR ALLE KINDER . *PH Bern Pädagogische Hochschule* . Marrë nga: https://jacobsfoundation.org/wp-content/uploads/2019/08/2019-08_Eintritt-in-die-Schule_Eine-Chance-f%C3%BCr-alles-Kinder_PHBern_JF.pdf.
- Epstein, L. J. (2001). *School, family, and community partnerships. Preparing educators and improving schools* . Westview Press .
- Erkan, S., & Topcu Bilir, Z. (2015). Okul Öncesi Eğitimin İlköğretim Birinci Sınıf Öğrencilerinin Türkçe Dil Becerilerine Etkisi The effects Of Preschool Education On First Graders School Turkish Language

Skills . *Okul Öncesi Egitimin İlköğretim Birinci Sınıf Öğrencilerinin Türkçe Dil Becerilerine Etkisi*
The effects Of Preschool Education On First Graders School Turkish Language Skills , 173-190.

Haliti, S. (2003). "*Artikuj të përzgjedhur pedagogjikë*". Gjilan .

Joey, P. D. (2003). *School readiness evaluation*. Brainline. URL . Brainline Learning World . Marrë nga:
<https://fr.scribd.com/document/197115825/Schoolready-Screening-Integral>.

Karaj, T. (2005). "*Psikologji e zhvillimit të fëmijës*". Tiranë.

Ladd, G. G. (2003). Probing the adaptive significance of children's behavior and relationships in the school context: A child-by-environment perspective. *Advances in Child Development and Behavior*, pp. 43-104.

Landry, S. H., Smith, K. E., R., S. P., & Guttentag, C. (2008). A responsive parenting intervention: The optimal timing across early childhood for impacting maternal behaviors and child outcomes. *Development Psychology*. APA PsycArticles .

Ligji Nr.04/L-032 Për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës (2011). Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr.17/16. Prishtinë.

Lincove, J., & Painter, G. (2006). *Does the age that children start kindergarten matter? Evidence of long-term educational and social outcomes*. Educational Evaluation and Policy Analysis, 28.

Matthews, E. C. (2008). *Investigating the association of parental influence and children's school readiness and early academic achievement: an analysis using early childhood longitudinal study-kindergarten (ecls-k)*. The Temple University .

Meisels, S. (1992). Doing harm by doing good: Iatrogenic effects of early childhood enrolment and promotion policies. *Early Childhood Research Quarterly* .

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (2016). *Kurrikula Bërthamë*. Prishtinë.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (2018). *Kurrikula Bërthamë për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme 0-5 vjeç*.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (2022). *Strategjia e Arsimit Parauniversitar në Republikën e Kosovës 2022-2026*.

MASHT; Nr.16/2004 Udhëzim Administrativ.

Musai, B. (1999). "*Psikologji Edukimi*". Tiranë.

NAYEC. (1995, November 22). NAYEC Position Statement on School Readiness. Marrë nga:
<https://www.naeyc.org/positionstatements/linguistic>

OECD. (2017). Starting Strong 2017. *Key Indicators on Early Childhood Education and Care* .

Perolli Shehu, B., Xhakollari, L., Hoti, A., & Kakija, A. (2019). "*Psikologji 11*". Prishtinë.

Pohlmann-Rother, S., Kratzmann, J., & Faust, G. (2011). Schulfähigkeit in der Sicht von Eltern, Erziher/innen und Lehrkräften . *Open Access Repository* , 57-73.

- Raver, C. C. (2002). *Emotions matter: Making the case for the role of young children's emotional development for early school readiness*. Social Policy Report, 16 (3).
- Rimm-Kaufmann, S., Pianta, C. R., & Martha, C. J. (2000). Teacher's judgments of problems in the transition to kindergarten. *Early Childhood Research Quarterly*, 15.
- Sharp, C. (2002). School starting age: European policy and recent research. . *International Journal of Educational Research* , pp. 1-29.
- Stamm, M. (n.d). Der Schuleintritt. *Sieben wissenschaftliche Erkenntnisse für die bildungspolitische HarmoS-Diskussion*, 1-33. Marrë nga: <https://margritstamm.ch/dokumente/dossiers/4-dossier-der-schuleintritt-2010/file.html>.
- Stipek, D. (2002). *At what age should children enter kindergarten? A question for policy makers and parents*. Society for Research in Child Development Social Policy Report.
- Suggate, S. P. (2009). School entry age and reading achievement in the 2006 Programme for International Student Assessment (PISA). *International Journal of Educational Research* ,48 (3) , 151-161.
- UNESCO. (2012). *School Readiness and Transitions* . UNESCO .
- Vadahi, F. (2002). *Pedagogjia Parashkollore* . Shkodër.
- Vosnidau, S. (2001). How children learn. *International Burea of Education - UNESCO*.
- West, J. ., Hausken, G. E., & Collins, M. (DC: 1993). *Readiness for Kindergarten: Parent and Teacher Beliefs* U.S. National Center for Educational Statistics (NCES), Department of Education Office for Educational Research and Improvement, Washington. Retrieved from National Center for Education Statistics (NCES).
- Woolfolk, A. (2011). *"Psikologji Edukimi" Qendra për Arsim Demokratik* . Tiranë.
- Zabeli, N. (2023). *"Mësimdhënia efektive dhe Kurrikula"* . Prishtinë.
- Zuna-Deva, A. (2003). *Edukimi i parashkollorit në familje* . Prishtinë.
- Zuna-Deva, A. (2009). *Partneriteti Shkollë-Familje-Komunitet*. Prishtinë.

SHTOJCAT

Shtojca A: PYETËSOR PËR MËSIMDHËNËS

TEMA: MOSHA OPTIMALE PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E PARË

Të nderuar mësues,

Në kuadër të hulumtimit mbi “Moshën optimale për regjistrimin e nxënësve në klasën e parë”, kemi përgatitur këtë pyetësor me qëllim të mbledhjes së mendimeve dhe përvojave tuaja si profesionistë në fushën e arsimit. Emri im është Valentina Ahmeti, dhe jam studente në Fakultetin e Edukimit në programin Master: Mësimdhënie dhe Kurrikula në Arsimin Fillor në Gjilan.

Qëllimi i këtij pyetësoi është shqyrtimi i moshës optimale për regjistrimin e nxënësve në klasën e parë si dhe, të identifikojmë ndikimet psikologjike që shoqërojnë regjistrimin e fëmijëve në klasën e parë, për t’u ofruar prindërve dhe përcaktuesve të politikave një udhëzues të vlefshëm mbi moshën më të përshtatshme për fillimin e arsimit formal.

Pyetësoi është i ndarë në tri pjesë kryesore:

1. Informacion i përgjithshëm – për të ndarë përvojën tuaj si mësimdhënës.
2. Aspekti psikologjik – për të vlerësuar ndikimin e moshës në pjekurinë emocionale dhe kognitive të nxënësve.
3. Aspekti pedagogjik – për të analizuar efektet e moshës në aftësitë akademike dhe përqendrimin e nxënësve.

Ky pyetësor mund të na ndihmojë të kuptojmë më mirë nevojat emocionale dhe sociale të fëmijëve në faza të zhvillimit të tyre, si dhe të identifikojmë kriteret që ju si mësues i konsideroni të rëndësishme për të lehtësuar procesin e adaptimit të nxënësve të rinj në ambientin shkollor.

Ashtu siç e dimë, një adaptim i suksesshëm në shkollë ka një ndikim të drejtpërdrejtë në performancën akademike dhe zhvillimin e përgjithshëm të fëmijëve.

Pjesëmarrja juaj në këtë pyetësor është në mënyrë vullnetare. Pyetjet janë krejtësisht të mbyllura dhe kërkojnë që ju të rrethoni përgjigjen që më së miri reflekton mendimin tuaj. Përgjigjet e dhëna nga ana juaj janë plotësisht anonime dhe konfidenciale.

Zgjidhni vetëm një opsion, përpos në pyetjet kur kërkohen më shumë opsione.

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

1. Sa vite përvojë keni si mësues në klasën të parë?

- a) Më pak se 3 vite
- b) 3-5 vite
- c) 6-10 vite
- d) Më shumë se 10 vite

2. Sa është numri mesatar i nxënësve në klasën tuaj të parë?

- a) 15-20
- b) 21-25
- c) 26-30
- d) Më shumë se 30

3. Cila është moshë mesatare e nxënësve që regjistrohen në klasën tuaj të parë?

- a) 5 vjeç
- b) 6 vjeç
- c) 7 vjeç
- d) 8 vjeç

4. A ka shkolla juaj ndonjë kriter shtesë për pranimin e nxënësve në klasën tuaj të parë, përveç moshës?

- a) Po, (p.sh., test psikologjik, intervistë me prindërit)
- b) Jo

2.ASPEKTI PSIKOLOGJIK

5. Sa të përgatitur janë fëmijët për t'iu përshtatur rregullave dhe rutinës shkollore kur fillojnë klasën e parë?

- a) Shumë të përgatitur
- b) Mesatarisht të përgatitur
- c) Pak të përgatitur
- d) Të papërgatitur

6. Cilat janë karakteristikat më të rëndësishme të gatishmërisë për fëmijët që fillojnë klasën e parë? (Zgjidhni maksimum 3).

- a) Aftësitë sociale
- b) Aftësitë emocionale
- c) Aftësitë gjuhësore
- d) Aftësitë motorike
- e) Aftësitë kognitive

7. Cili faktor mendoni se është më i rëndësishmi për përcaktimin e moshës së regjistrimit në klasën e parë?

- a) Zhvillimi kognitiv, emocional dhe social i fëmijës
- b) Rregulloret dhe politika arsimore
- c) Përvoja e fëmijës në arsimin parashkollor
- d) Vlerësimi i prindërve për gatishmërinë e fëmijës

8. Cilat janë sfidat më të zakonshme që hasni me nxënësit në moshë të hershme ose të mëvonshme në klasën e parë?

- a) Vështirësi në të mësuar
- b) Vështirësi në integrimin social
- c) Vështirësi në përqendrim
- d) Vështirësi në menaxhmin e emocioneve

3.ASPEKTI PEDAGOGJIK

9. A keni vënë re ndonjë dallim në performancën e nxënësve në varësi të moshës së regjistrimit?

- a) Po, ka dallime të mëdha
- b) Po, por jo të dukshme
- c) Jo, nuk ka dallime
- d) Nuk kam vërejtur

10. Në cilat fusha nxënësit që regjistrohen në një moshë më të hershme kanë më shumë vështirësi? (mund të zgjidhni më shumë se një opsion).

- a) Lexim
- b) Shkrim
- c) Matematikë
- d) Përqendrim dhe ndjekja e udhëzimeve

11. Bazuar në përvojën tuaj, cila do të ishte mosha më e përshtatshme për regjistrimin e nxënësve në klasën e parë?

- a) 5 vjeç
- b) 6 vjeç
- c) 7 vjeç

12. Cila është mënyra më e mirë për të informuar prindërit mbi gatishmërinë e fëmijëve të tyre për të regjistruar në klasën e parë?

- a) Takime të drejtpërdrejta
- b) Fletushka informuese
- c) Internet/media sociale
- d) Lidhje personale me prindërit

13. Në bazë të përvojës tuaj, çfarë do të sugjeronit për te ndihmuar fëmijët që fillojnë shkollën të përshtaten më lehtë emocionalisht dhe socialisht? (Përgjigje e hapur)

Faleminderit për kohën dhe kontributin tuaj në këtë hulumtim! Mendimet tuaja janë shumë të vlefshme dhe do të ndihmojnë në avancimin e praktikave më të mira për regjistrimin dhe edukimin e fëmijëve të rinj.

Shtojca B: PYETËSOR PËR PRINDËR

TEMA: MOSHA OPTIMALE PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E PARË

Të nderuar prindër,

Jeni përzgjedhur për të dhënë mendimin tuaj duke plotësuar këtë pyetësor. Emri im është Valentina Ahmeti, jam studente në Fakultetin e Edukimit programi Master: Mësimdhënie dhe Kurrikula në Arsimin Fillor në Gjilan. Ky pyetësor është krijuar për të mbledhur mendime dhe përvojat tuaja mbi moshën e përshtatshme për regjistrimin e nxënësve në klasën e parë, me fokus në aspektet psikologjike të kësaj çështjeje. Mendimet dhe vlerësimet tuaja do të ndihmojnë në zhvillimin e një kuptimi më të thellë për nevojat emocionale dhe psikologjike të fëmijëve në këtë periudhë të rëndësishme të jetës së tyre.

Të dhënat do të ndihmojnë në:

- Kuptimin e sfidave emocionale dhe sociale të fëmijëve gjatë tranzicionit në shkollë.
- Ofrimin e rekomandimeve për mbështetjen më të mirë të fëmijëve gjatë këtij procesi.

Pyetësori është i ndarë në tri pjesë kryesore:

4. Informacion i përgjithshëm – për të ndarë përvojën tuaj.
5. Aspekti psikologjik – për të vlerësuar ndikimin e moshës në pjekurinë emocionale dhe kognitive të fëmijëve
6. Aspekti pedagogjik – për të analizuar efektet e moshës në aftësitë akademike dhe përqendrimin e nxënësve.

Pjesëmarrja juaj në këtë pyetësor është në mënyrë vullnetare. Pyetjet janë krejtësisht të mbyllura dhe kërkojnë që ju të rrethoni përgjigjen që më së miri reflekton mendimin tuaj.

Përgjigjet e dhëna nga ana juaj janë plotësisht anonime dhe konfidenciale.

Zgjidhni vetëm një opsion, përpos në pyetjet kur kërkohen më shumë opsione.

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

- 1. Gjinia e fëmijës:** a) femër b) mashkull

- 2. A ka ndjekur fëmija juaj çerdhen ose kopshtin para se të regjistrohet në klasën e parë?**
 - a) Po, ka ndjekur çerdhen
 - b) Po, ka ndjekur kopshtin
 - c) Jo, ka filluar direkt në klasën e parë

- 3. Në çfarë moshe keni regjistruar fëmijën tuaj në klasën e parë?**
 - a) 5 vjeç
 - b) 6 vjeç
 - c) 7 vjeç

- 4. Cilat ishin arsyet kryesore për të zgjedhur këtë moshë për regjistrim? (mund të zgjidhni më shumë se një opsion).**
 - a) Rekomandimet e shkollës ose mësuesve
 - b) Zhvillimi i fëmijës tim (kognitiv / emocional)
 - c) Moshë ligjore e pranimi në shkollë
 - d) Dëshira për të filluar sa më shpejt edukimin formal
 - e) Përputhja me orarin familjar dhe punën e prindërve

2. ASPEKTI PSIKOLOGJIK

- 5. A keni diskutuar me psikologun e shkollës, mësuesit apo edhe me ndonjë prind tjetër për moshën e duhur të regjistrimit të fëmijëve?**

- a) Po
- b) Jo

Nëse po, me kë:

6. Si ka reaguar fëmija juaj emocionalisht gjatë ditëve të para të shkollës?

- a) Ishte i/e lumtur
- b) Ishte paksa i/e shqetësuar
- c) Ishte i/e stresuar dhe kishte vëshitrësi të mëdha në përshtatje
- d) Vazhdoi të ndjejë ankth për një periudhë të gjatë

7. A mendoni se mbështetja e mësuesve ndihmoi fëmijën tuaj të përshtatej emocionalisht në klasën e parë?

- a) Shumë
- b) Mesatarisht
- c) Pak
- d) Aspak

8. Cilat ishin sfidat më të mëdha që përjetoi fëmija juaj në fillim të klasës së parë? (mund të zgjidhni më shumë se një opsion)

- a) Mësimi i shkronjave dhe numrave
- b) Përqendrimi dhe ndjekja e mësimi
- c) Krijimi i miqësive dhe përshtatja me grupin
- d) Pranimi i rregullave dhe proceduarve të klasës
- e) Nuk kishte sfida të mëdha

3. ASPEKTI PEDAGOGJIK

9. A mendoni se mosha e regjistrimit ndikon në suksesin e fëmijës tuaj?

- a) Po, fëmijët më të vegjël mund të kenë më shumë vështirësi në mësim
- b) Po, fëmijët më të mëdhenj janë më të përgatitur për mësim
- c) Jo, mosha nuk ka ndikim të madh në suksesin mësimor

10. A keni ndihmuar fëmijën tuaj në përgatitjen për klasën e parë? Nëse po, cilat aktivitete keni përdorur? (mund të zgjidhni më shumë se një opsion).

- a) Lexim dhe tregim përrallash
- b) Ushtrime matematikore bazë
- c) Aktivitete për zhvillimin e shkathtësive motorike (shkrim, vizatim, lojëra)
- d) Përgatitje emocionale (biseda mbi shkollën, vizita në shkollë paraprakisht)
- e) Nuk kam bërë ndonjë përgatitje të veçantë

11. A mendoni se programi mësimor i klasës së parë është i përshtatshëm për moshën e fëmijës tuaj?

- a) Po
- b) Jo

12. Sipas jush, cila është mosha më e përshtatshme për të filluar klasën e parë?

- a) 5 vjeç
- b) 6 vjeç
- c) 7 vjeç
- d) Më shumë se 7 vjeç

Çfarë sugjerimesh keni për prindërit e tjerë për të përgatitur më mirë fëmijën e tyre për fillimin e shkollës?

(Përgjigje e hapur)

Faleminderit për kohën dhe kontributin tuaj! Përgjigjet tuaja do të ndihmojnë në përmirësimin e mbështetjes për fëmijët gjatë fillimit të tyre në shkollë.